REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 nëntor 2025
Nr. ref.: AGJ2867/25

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI04/24

Parashtrues

Fabrika e Enëve "ENA" SH.A.

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001] të 9 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fabrika e Enëve "ENA" SH.A. në Gjakovë, e përfaqësuar nga Ruzhdi Kumnova, drejtor i Fabrikës së Enëve "ENA" SH.A. (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001] të 9 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: Kolegji i Apelit i DHPGJSK), në ndërlidhje me Aktvendimin [SCC-08-0243] e 5 tetorit 2023 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: DHPGJSK).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, përmes të cilit pretendohet se parashtrueses së kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 janar 2024, parashtruesja e kërkesës dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 25 janar 2024, Kryetarja përmes Vendimit [Nr. GJR. KI04/24] e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi, gjyqtar raportues dhe përmes Vendimit [Nr.KSH.KI04/24] e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Remzie Istrefi-Peci (anëtarë).

7. Më 30 janar 2024, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 2 shkurt 2024, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës pranë Gjykatës e dërgoi një shkresë me informata lidhur me adresën dhe kontaktin.

9. Më 19 nëntor 2024, Gjykata i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta sjellë autorizimin për përfaqësim.

10. Më 4 dhjetor 2024, përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin.

11. Më 10 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës, rregullin 8 (Zgjedhja e Kryetarit/es dhe e Zëvendëskryetarit/es) të Rregullores së punës dhe Vendimin e Gjykatës [KK-SP 812-1/24] të 10 dhjetorit 2024, gjyqtari Nexhmi Rexhepi u zgjodh Kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimin e lartcekur të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtari Nexhmi Rexhepi, detyrën e Kryetarit të Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Gresa Caka-Nimani, më 30 dhjetor 2024.

12. Më 30 dhjetor 2024, bazuar në paragrafin 2 të rregullit 8 të Rregullores së punës dhe Vendimin e [KK-SP 812-1/24] e 10 dhjetorit 2024 të Gjykatës, gjyqtari Nexhmi Rexhepi e mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Gresa Caka-Nimani e përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

13. Në të njëjtën ditë, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 të Ligjit, edhe gjyqtarja Selvete Gërxhaliu-Krasniqi e përfundoi mandatin e gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

14. Më 8 janar 2025, Kryetari i Gjykatës, Nexhmi Rexhepi, përmes Vendimit [GJR.KI04/24] e caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues, në vend të tij, pasi i njëjti e mori detyrën e Kryetarit të Gjykatës më 30 dhjetor 2024.

15. Më 8 janar 2025, Kryetari i Gjykatës, Nexhmi Rexhepi, përmes Vendimit [KSH.KI04/24] e caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi anëtar në Kolegjin Shqyrtues, në vend të Selvete Gërxhaliu-Krasniqit, mandati i së cilës si gjyqtare kishte përfunduar më 30 dhjetor 2024. Bazuar në pikën I të vendimit të lartcekur, Kolegji Shqyrtues ka këtë përbërje: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).

16. Më 21 mars 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë DHPGJSK-së dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë informatat e nevojshme përkitazi me pyetjet në vijim: (i) Specifikisht, nga cila datë është regjistruar kërkesëpadia e saj në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme? (ii) A është mbajtur ndonjë seancë përgatitore lidhur me kërkesëpadinë e parashtrueses së kërkesës, nëse po, sa seanca janë mbajtur deri më sot? (iii) A është mbajtur ndonjë seancë dëgjimore? (iv) A keni ftuar dëshmitarë që të dëshmojnë lidhur me rastin? (v) A ka pasur palë të interesuara për rastin dhe a i keni dëgjuar ato?, dhe (vi) Në cilën fazë të procedurës gjendet shqyrtimi i kërkesëpadisë së saj?

17. Më 21 mars 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore në Gjakovë, dhe kërkoi nga ato që ta informojnë Gjykatën se a ka dorëzuar parashtruesja e kërkesës kallëzim penal kundër AKP-së, dhe nëse po, (i) a keni filluar procedurën në bazë të kallëzimit penal, përkatësisht a keni ngritur aktakuzë kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pra çfarë hapash janë ndërmarrë lidhur me kallëzimin penal në fjalë? dhe (ii) në çfarë faze ndodhet procedura e filluar në bazë të kallëzimit penal?

18. Më 26 mars 2025, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës e njoftoi Gjykatën se me datë 19 qershor 2023 është pranuar kallëzimi penal nga Ruzhdi Kumnova, drejtor i Fabrikës së Enëve "ENA" sh.a, dhe se bazuar në Ligjin nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale (tanimë i shfuqizuar me Ligjin nr.08/L-168 për Prokurorinë Speciale) nuk ka pasur kompetencë lëndore që ta trajtojë këtë rast, pasi veprimet e pretenduara si në kallëzim penal nuk kanë përmbajtur elemente të veprave penale për të cilat Prokuroria Speciale ka pasur kompetencë për trajtim. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 81, paragrafin 3

të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, kallëzimin penal të parashtruesit Ruzhdi Kumnova, e ka deleguar në kompetencë të Prokurorisë Themelore Prishtinë, si prokurori kompetente për trajtimin e rastit në fjalë.

19. Më 3 prill 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë informatat e nevojshme përkitazi me pyetjet në vijim: (i) a keni filluar procedurën në bazë të kallëzimit penal, përkatësisht a keni ngritur aktakuzë kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pra çfarë hapash janë ndërmarrë lidhur me kallëzimin penal në fjalë? dhe (ii) në çfarë faze ndodhet procedura e filluar në bazë të kallëzimit penal?

20. Më 28 mars 2025, Prokuroria Themelore në Gjakovë dorëzoi në Gjykatë një shkresë përmes së cilës e njoftoi Gjykatën se parashtruesja e kërkesës përmes përfaqësuesit, avokat Teki Bokshi, me drejtor Ruzhdi Kumnova, kanë parashtruar kallëzim penal kundër AKP-së, kundër F.M, zyrtar i AKP-së, B.K dhe M.V nga Gjakova për dyshimin e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

21. Më 8 prill 2025, pasi që Gjykata nuk pranoi informatat e kërkuara nga ana e DHPGJSK-së, iu drejtua me një shkresë Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kërkoi nga ai që duke përdorur autorizimin e tij si KGJK t'i sigurojë Gjykatës përgjigjet e gjykatës përkatëse në lidhje me kërkesën e Gjykatës drejtuar DHPGJSK-së.

22. Më 10 prill 2025, KGJK e njoftoi Gjykatën se i është drejtuar dhe ka kërkuar nga DHPGJSK-ja që ta trajtojë kërkesën e Gjykatës.

23. Më 11 prill 2025, DHPGJSK-ja përmes një shkrese dorëzuar Gjykatës njoftoi se rasti në fjalë është regjistruar në DHPGJSK me shenjën SCC-08-0243, me datë 4 gusht 2008, dhe se rasti ka kaluar nga një gjyqtare te një gjyqtar tjetër dhe se planifikojnë të mbajnë seancë dëgjimore gjatë muajit qershor 2025, por jo më larg se deri në muajin korrik 2025.

24. Më 8 maj 2025, Gjykata i dërgoi një shkresë Prokurorisë Themelore Gjakovë dhe kërkoi informatat se çfarë hapash janë ndërmarrë lidhur me kallëzimin penal pas pranimit të raportit hetimor nga ana e policisë dhe në çfarë faze ndodhet procedura e filluar.

25. Më 16 maj 2025, Prokuroria Themelore në Gjakovë e njoftoi Gjykatën lidhur me hapat e ndërmarrë lidhur me kallëzimin penal.

26. Më 13 tetor 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe vendosi që të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës.

27. Më 5 nëntor 2025, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi:(i) të deklarojë njëzëri kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë, njëzëri, se ka shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm; (iii) të konstatojë, me pesë (5) vota për dhe dy (2) kundër, se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht shkelje të parimit të

sigurisë juridike; (iv) të urdhërojë, Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që të vendosë lidhur me meritat e rastit më së largu deri më 1 qershor 2026 dhe të njoftojë Gjykatën, në pajtim me nën rregullin (5) të rregullit 60 të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

28. Parashtruesja e kërkesës parashtron kërkesë për herën e dytë para Gjykatës, përkatësisht kishte parashtruar edhe kërkesën KI104/19, të cilën Gjykata e kishte refuzuar me procedurë të shkurtër, për shkak të mosdorëzimit të autorizimit nga ana e përfaqësuesit të parashtrueses së kërkesës.

29. Nga shkresat e lëndës, rezulton se më 23 janar 1991, Këshilli i punëtorëve mori vendim mbi organizimin – themelimin e Shoqërisë Aksionare – Fabrika e Enëve sh.a, në kuadër të ndërmarrjes Holding "Metaliku".

30. Më 9 shkurt 1991, në bazë të ligjeve në fuqi në atë kohë, ishte nënshkruar kontrata për themelimin e shoqërisë aksionare në pronësi të përzier Fabrika e Enëve me seli në Gjakovë.

31. Më 15 shkurt 1991, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Gjakovë përmes vendimit [Fi Nr.505/91] kishte vërtetuar themelimin dhe regjistrimin si shoqëri aksionare me emrin "Fabrika e Enëve" me seli në Gjakovë, në kuadër të ndërmarrjes Holding "Metaliku".

32. Më 27 shtator 1991, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Gjakovë përmes aktvendimit [Fi.Nr.2359/91] kishte vendosur që Fabrika e Enëve të ndahet nga Ndërmarrja Holding "Metaliku" , për të vepruar si person i pavarur juridik me emrin Fabrika e Enëve "Teflon 2", me seli në Gjakovë.

33. Bazuar në shkresat e lëndës, më 5 shtator 2000, pranë Administratës së përkohshme civile të OKB-së, Fabrika e Enëve "Ena" regjistrohet dhe i lëshohet certifikata e regjistrimit me nr.80175043.

34. Më 29 maj 2003, parashtruesja e kërkesës paraqiti dokumentet për regjistrim si shoqëri aksionare pranë zyrës së regjistrimit të bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

35. Në një datë të pasaktësuar, pasi që zyra për regjistrim në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë nuk i ktheu përgjigje për moslëshimin e certifikatës së regjistrimit, parashtruesja e kërkesës paraqiti padi pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut kundër Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë – Agjencisë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve dhe Emrave Tregtarë. Përmes padisë, kërkoi që të obligohet e paditura që të vendosë sipas kërkesës së paraqitur për regjistrimin e parashtrueses së kërkesës në regjistrin e bizneseve dhe emrave tregtarë, në afatin prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit dhe t'ia paguaj shpenzimet e procedurës gjyqësore në afat prej 8 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

36. Më 31 korrik 2006, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë përmes Aktgjykimit [VI.C.nr.118/2006] e aprovoi padinë e parashtrueses së kërkesës dhe e obligoi të padituren Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë – Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve dhe Emrave Tregtarë që të vendosë sipas kërkesës së paraqitur për regjistrimin e parashtrueses të kërkesës në regjistrin e bizneseve të emrave tregtarë, në afat prej 10 ditësh të punës, duke llogaritur nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

37. Më 14 shtator 2006, Zyra e Regjistrimit të Bizneseve dhe Emrave Tregtarë në Kosovë i lëshoi certifikatën e biznesit parashtrueses së kërkesës me emrin tregtar Fabrika e Enëve "Ena" SH.A, ndërsa te lloji i biznesit e emëroi Ndërmarrje të tjera nën juridiksion të AKM-së. Gjithashtu, në certifikatën e biznesit ishte cekur se pronari tani për tani është i padefinuar.

Procedura lidhur me padinë për njohjen e statusit të shoqërisë aksionare dhe kërkesën për masë paraprake të sigurisë për mosshitjen e fabrikës nga ana e AKP-së

38. Më 4 gusht 2008, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi pranë DHPGJSK-së kundër Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejmë: AKM) dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejmë: AKP). Parashtruesja e kërkesës përmes padisë kërkoi njohje të plotë të statusit të saj si shoqëri aksionare, duke filluar nga viti 1991, respektivisht nga 29 maj 2003 dhe largimi i saj nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit.

39. Më 24 gusht 2010, parashtruesja e kërkesës parashtroi pranë DHPGJSK-së kërkesë për lëshimin e masës së përkohshme kundër privatizimit të New Co Metaliku Ena Sh. A në Gjakovë, e shpallur për privatizim nga AKP-ja, si dhe kërkoi nga gjykata që e njëjtë ta ndalojë AKP-në nga shitja e ndonjë pjese të Fabrikës së Enëve "ENA" sh.a, apo ndërmarrjes së emëruar nga AKP si NSH "ENA".

40. Më 5 dhe 6 shtator 2011, me urdhrin e DHPGJSK-së iu dërgua kërkesa për masë të përkohshme AKP-së dhe AKM-së.

41. Më 7 shtator 2011, AKM-ja paraqiti përgjigjen e saj pranë DHPGJSK-së, duke theksuar se është pajtuar me kërkesën e parashtrueses së kërkesës për lëshimin e një mase paraprake kundër AKP-së, dhe se sipas mendimit të saj, nëse nuk lëshohet e njëjta, ka gjasa për dëm apo humbje të menjëhershme dhe të pariparueshme për parashtruesen e kërkesës, duke marrë parasysh shpalljen e pashmangshme të tenderit të AKP-së që do realizohet më 10 shtator 2011.

42. Në datën e njëjtë, AKP-ja ka paraqitur përgjigjen e saj pranë DHPGJSK-së, duke kërkuar që kërkesa për masë paraprake të refuzohet si e pabazuar, duke e konsideruar të panevojshme dhe të paarsyeshme, për faktin se, nëse DHPGJSK-ja lëshon një vendim në favor të parashtruesit të kërkesës, atëherë ai duhet të kompensohet siç e parasheh ligji, neni 10.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.

43. Më 23 shtator 2011, DHPGJSK-ja përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] e miratoi kërkesën për lëshimin e masës paraprake dhe ia ndaloi AKP-së shitjen e aseteve të hedhura për privatizim të New Co Metaliku Ena sh.a. nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimi, dhe kjo masë mbetet në fuqi deri në vendimin përfundimtar të padisë nga DHPGJSK-ja. Tutje, masën paraprake e miratoi me kusht të depozitimit nga paditësi brenda 24 orëve nga pranimi i këtij aktvendimi të një depozite në shumë 1000 euro, për kompensimin e të padituarave për ndonjë dëm që mund t'u shkaktohet atyre po qe se padia e tyre nuk materializohet, e njëjta duhet të depozitohet në llogarinë depozituese të DHPGJSK-së. Në arsyetimin e aktvendimit, DHPGJSK theksoi se kërkesa prima facie i plotëson kushtet e nenit 55 të Urdhëresës Administrative 2008/6 (UA) për faktin se statusi juridik i parashtruesit të kërkesës është i papërcaktuar, ndërsa në rast se asetet do të shiteshin, dëmi do të ishte i menjëhershëm dhe i pariparueshëm.

44. Në një datë të pasaktësuar, AKP-ja parashtroi ankesë ndaj Aktvendimit [SCC-08-0243] të DHPGJSK-së pranë Kolegjit të Apelit, duke pretenduar se me të njëjtin janë bërë shkelje procedurale dhe është dhënë një argumentim i paqëndrueshëm. Sipas AKP-së, shkelja procedurale qëndron në faktin se DHPGJSK nuk ka vlerësuar raportin juridik të përfaqësuesit të paditësit, Olivier Borg dhe AKM-së, ku i njëjti ka pasur një pozitë të lartë menaxheriale, dhe kjo situatë përbën konflikt interesi. Po ashtu, AKP-ja pretendoi se Kolegji i Specializuar nuk e ka argumentuar *"Status Determination Raport (SDR)",* sipas të cilit Fabrika e Enëve ishte njësi e NSH "Metaliku" me kapital shoqëror dhe se transformimi i pretenduar i parashtruesit të kërkesës i ndodhur në vitin 1991, nuk ishte në pajtim me ligjin.

45. Më 12 tetor 2012, parashtruesja e kërkesës parashtroi përgjigje në ankesë, duke konsideruar se ankesa e AKP-së është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet. E njëjta theksoi se konflikti i interesit nuk ekziston, për faktin se kërkesa për masë të përkohshme është parashtruar nga përfaqësuesi av. Bajram Morina, dhe se gjithashtu ka parashtruar Vendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Gjakovë, me të cilin ndërmarrja është shndërruar në shoqëri aksionare dhe se nuk është në kompetencë të AKP-së të caktojë status tjetër nga ai që e ka caktuar Gjykata, dhe se SDR është një akt i njëanshëm i AKP-së dhe nuk është i bazuar në gjendje faktike.

46. Më 25 tetor 2012, AKP-ja parashtroi përgjigje ndaj përgjigjes së parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se vendimi për regjistrim i gjykatës ka të bëjë me regjistrimin e veprimtarisë dhe jo pronësisë mbi pronën e pretenduar, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi me të cilat provon se kushtet për caktimin e masës së përkohshme janë plotësuar.

47. Më 4 mars 2015, Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [ASC-11-088-A0001] e refuzoi ankesën e të padituresë AKP lidhur me masën paraprake, dhe vërtetoi Aktvendimin [SCC-08-0243] e 23 shtatorit 2011 të DHPGJSK-së. Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së ndër të tjera arsyetoi: "*Gjithashtu në këtë rast nuk është kontestuese fakti se prona NSH-së është në proces të privatizimit për të cilën duhet të vërtetohet statusi juridik i saj. AKP-ja është e mandatuar me ligj t'i shet të gjitha asetet dhe patundshmëritë e NSH-së. Andaj AKP-ja në çdo rast do të mund të shes të gjitha patundshmëritë lëndore të NSH-së në të cilat kanë pretendime paditësit. Rrjedhimisht dëmi sipas kësaj baze faktike është i menjëhershëm dhe i pariparueshëm. Zhdëmtimi nuk do të mund të bëhej në menyrë të arsyeshme, nëse do të shiteshin tokat e kontestuara. Nëse paditësi del të jetë i suksesshëm në meritat e padisë pronën nuk do të mund ta kthejë më kurrë, andaj kompensimi financiar për këtë arsye nuk do të jetë i arsyeshëm*".

Procedura e dytë lidhur me padinë kundër AKP-së në lidhje me vendosjen e ndërmarrjes nën menaxhimin e AKP-së.

48. Më 21 përkatësisht 25 shtator 2017, Bordi i Drejtorëve i AKP-së përmes vendimit [Nr.Ref.BD-97/16] vendosi që Ndërmarrja Holding Industria Metalike " Metaliku" Ena Sh.a me seli në Gjakovë të vendoset nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKP-së dhe se AKP merr përsipër kontrollin e drejtpërdrejtë mbi këtë ndërmarrje, duke përfshirë këtu llogaritë bankare dhe asetet, si dhe administrimin e llogarive bankare dhe aseteve.

49. Më 27 tetor 2017, parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës [Nr.7617] drejtuar Bordit të Drejtorëve të AKP-së kërkoi që të rishqyrtohet dhe të anulohet Vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së, si dhe njoftoi se nëse eventualisht kërkesa për anulim nuk aprovohet

brenda afatit ligjor, atëherë do të parashtrojë padi në DHPGJSK për anulimin e vendimit të lartpërmendur.

50. Më 3 nëntor 2017, Drejtori Menaxhues i AKP-së përmes Njoftimit [Nr.7617/AV] e njoftoi parashtruesen e kërkesës se vendimi i bordit është marrë në përputhje me dispozitat ligjore, dhe se përcaktimi i statusit të parashtrueses si Ndërmarrje Shoqërore është bërë sipas SDR0715 të datës 22.06.2011, dhe se paditësi nuk ka ofruar prova tjera nga ato të cilat janë shqyrtuar më parë.

51. Më 25 janar 2018, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi kundër AKP-së pranë DHPGJSK-së, përmes së cilës kërkoi anulimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve nr. të Ref.BD – 76/16 të datës 25 shtator 2017, përmes të cilit bëhet vendosja e parashtruesit të kërkesës në Njësinë e Administrimit Direkt në kuadër të AKP-së. Po ashtu, parashtruesja e kërkesës propozoi caktimin e masës së parakohshme të sigurisë për ndalimin e ekzekutimit të të njëjtit dhe kërkoi bashkimin e lëndës së kësaj padie me padinë paraprake të saj pranë DHPGJSK-së [SCC-08-0243] të datës 12 qershor 2008.

52. Më 16 tetor 2018, DHPGJSK përmes Aktvendimit [SCC-08-0243]: I. caktoi urdhrin paraprak gjyqësor; dhe II. pezulloi zbatimin e Vendimit të Bordit të Drejtorëve [nr. të Ref.BD – 76/16] të datës 25 shtator 2017, deri në vendosje në merita të padisë, me një vendim të formës së prerë. DHPGJSK ndër të tjera arsyetoi se Vendimi i njëjtë ka shkelur detyrimin – masën e përkohshme që i është caktuar me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit [ASC 11-0088-A0001] të datës 4 mars 2015, me të cilin i është ndaluar AKP-së shitja e aseteve deri në përfundim të procedurës me një vendim të formës së prerë, dhe duke qenë se ende nuk është definuar statusi juridik i parashtruesit të kërkesës, shitja e aseteve të fabrikës pas përfshirjes nën administrimin e AKP-së, do të rezultonte në një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm.

53. Më 9 nëntor 2018, AKP-ja dorëzoi ankesë kundër Aktvendimit [SCC-08-0243] të 16 tetorit 2018 të DHPGJSK-së, duke pretenduar se i njëjti ka shkelur nenin 182 par.2 n) të LPK-së, pasi i njëjti ka të meta, është i pakuptueshëm, kontradiktor mes vete ose me arsyet e aktvendimit. Tutje, AKP në ankesë pohoi se, duke qenë se Aktvendimi është marrë me datë 16 tetor 2018 pas përfundimit të mandatit të gjyqtarëve të EULEX-it dhe një vendim i tillë nuk është në përputhje me Ligjin e Dhomës së Posaçme. Po ashtu, pohon se është duke e zbatuar masën e përkohshme të caktuar nga DHPGJSK më 23 shtator 2011, dhe se nga kjo datë Agjencia nuk ka tenderuar dhe nuk do të tenderojë asnjë aset për shitje deri në përfundim të procedurës. AKP-ja konsideroi se Vendimi i ankimuar i Bordit të Drejtorëve nuk e shkel masën e përkohshme të caktuar nga DHPGJSK, por vendosjen e NSH-së nën administrimin AKP e konsideron të arsyeshme për të ruajtur vlerën e aseteve, shanseve në sukses ose qeverisjes së ndërmarrjes të cilat po bëhen në favor të NSH-së.

54. Më 20 dhjetor 2018, Kolegji i Ankesave i DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [AC-I-18-0548], vlerësoi: (i) si të bazuar ankesën e AKP-së; (ii) ndryshoi Aktvendimin e Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK-së [SCC-08-0243] të datës 16 tetor 2018; (iii) kërkesa e paditësit për caktimin e masës së përkohshme u refuzua si e pabazuar. Kolegji i Apelit ndër të tjera arsyetoi se "*paditësi ka dështuar ti ofroj gjykatës prova se dëmi mund të jetë i menjëhershëm dhe i pariparueshëm nëse nuk do të lëshohej masa e përkohshme e kërkuar. Vendimi i Bordit të AKP-së nuk mund të ndryshon statusin aktual juridik të kontestuar të paditëses. Ky vendim vetëm i mundëson AKP-së që aktualisht të ushtroj një kontroll të drejtpërdrejtë ndaj aseteve të NSH-së, asgjë*

më tepër. Ky vendim nuk rrezikon shitjen e aseteve që tanimë janë të mbrojtura me masën e përkohshme të caktuar më herët".

55. Më 23 janar 2019, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur kërkesë për rishqyrtimin dhe për përsëritjen e procedurës ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Apelit [AC-18-0548] të 20 dhjetorit 2018.

56. Më 28 shkurt 2019, Kolegji i Ankesave të DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0013] e hodhi poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtrueses së kërkesës për rishqyrtim dhe përsëritje të procedurës ndaj Aktvendimit [AC-I-18-0548] të 20 dhjetorit 2018 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, sepse i njëjti është i formës së prerë dhe parashtruesja e kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument të ri ligjor që nuk është paraqitur më herët.

Procedura e tretë lidhur me padinë dhe kërkesën për masë të sigurisë lidhur me demontimin e makinerisë dhe shitjen e tyre

57. Më 24 mars 2022, AKP-ja shpalli ofertë për zhvendosjen e pajisjeve nga repartet e prodhimit në NSH Metaliku Ena Gjakovë.

58. Më 11 maj 2022, parashtruesja e kërkesës ka dorëzuar një parashtresë – kërkesë për plotësimin e masës së përkohshme në DHPGJSK, përmes së cilës kërkoi caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me të cilën i ndalohet AKP-së ndërmarrja e veprimit për heqjen, demontimin dhe largimin i makinave dhe pajisjeve të tjera nga repartet e fabrikës së enëve në Gjakovë dhe që të ndryshojë gjendjen në objektin e fabrikës, po ashtu ta rikthejë gjendjen fillestare dhe pajisjet në fabrikë, siç ishte para demontimit dhe bartjes së makinave dhe pajisjeve të tjera jashtë fabrikës.

59. Më 6 qershor 2022, DHPGJSK përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për caktimin e masës të sigurimit, me të cilën kishte kërkuar t'i ndalohet AKP-së marrja e veprimeve për heqjen, demontimin dhe largimin e makinerive dhe pajisjeve të tjera nga Fabrika e Enëve në Gjakovë, në ngastrat: 1. P-70705028-04346-1, Zona Kadastrale Gjakovë, jashtë qytetit, lloji i njësisë, parcelë, tipi i pronës, shoqërore, vendi i quajtur Piskotë, sipërfaqja 9625m2, shfrytëzim aktual bujqësore, arat –arë e klasës 3, pjesë e pronës 1/1 i të drejtës së posedimit individual; 2. P-70705028 -04342-2, Zona Kadastrale Gjakovë, jashtë qytetit, lloji i njësisë, parcelë, tipi i pronës, shoqërore, vendi i quajtur Piskotë, sipërfaqja 7712m2, shfrytëzim aktual bujqësore, kullosat – kullos e klasës 1, pjesë e pronës 1/1 i të drejtës së posedimit individual. 3. P-70705028-04342-2, Zona Kadastrale Gjakovë, jashtë qytetit, lloji i njësisë, parcelë, tipi i pronës, shoqërore, vendi i quajtur Piskotë, sipërfaqja 5240m2 shfrytëzim aktual bujqësore, livadhet, e klasës 2, pjesë e pronës 1/1 i të drejtës së posedimit individual. 4. P-70705028-me kulturë rrugë publike, ZK Gjakovë – jashtë qytetit. DHPGJSK ndër të tjera arsyetoi se parashtruesja e kërkesës nuk e ka argumentuar me prova dhe dëshmi pretendimin në lidhje me dëmin e pariparueshëm, gjegjësisht " *... se demontimi dhe zhvendosja e pajisjeve dhe makinerive në një hapësirë tjetër brenda Fabrikës nuk është argumentuar me prova qe nuk mund të bëhet rikthimi në gjendjen e mëparshme. Kjo për faktin se makineritë dhe pajisjet mund të montohen dhe çmontohen pa u prishur dhe dëmtuar, kur bëhen nga profesionistet të fushës, sikundër edhe struktura e objektit/objekteve që mund të ndryshohet dhe të rikthehet në gjendje ekzistuese kur veprohet me ekipe profesionale të fushës së ndërtimtarisë, sikundër që dëmtimet eventuale gjatë montimit dhe çmontimit, ato janë të natyrës që mund të evitohen*".

60. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [SCC-08-0243] të 6 qershorit 2022 të DHPGJSK-së, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

61. Më 8 gusht 2022, koordinatori i N.SH "Metaliku – Fabrika e Enëve", i emëruar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së, kishte lidhur kontratë me "Viva Fresh Sh.p.k" për demontimin e makinerisë, rrënimin e objekteve dhe infrastrukturës dhe ndërtimin e qendrës tregtare afariste.

62. Më 16 janar 2023, Viva Fresh Sh.p.k përmes kërkesës me numër [07-351/02-914], drejtuar Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës, kishte kërkuar lëshimin e lejes së rrënimit, që t'i lejohet ndërhyrja rrënimi i pjesëve të objekteve të kategorisë së II-të, me destinim objekte industriale dhe depo, të cilat gjenden në rrugën "Gjergj Sokoli – Papa Klementi" në parcelat kadastrale me numër: 4341-1, 43-42-1, 43-46-1, 43-47-0, ZK: Gjakovë –J-Qytet, me qëllim të evitimit të rrezikut të shembjes së kulmit, për shkak të gjendjes ekzistuese faktike, e cila referuar raportit me nr.4917, nr.Fq.2, i datës 23.11.2022, i rekomanduar sipas Vendimit me Nr.Ref.BD-173/67, dt.20.11.2022, nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së, i lëshuar nga projektuesi Guri-ds, Sh.p.k Prishtinë, me investitor Viva Fresh Sh.p.k për AKP-në, rezulton të jetë me trarë të kalbur, me shtylla-trarë konstruktive që kanë humbur aftësinë mbajtëse të tyre.

63. Më 22 shkurt 2023, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Gjakovës përmes Vendimit [Nr.07/351/02-914] lëshoi leje rrënimi përmes së cilës iu lejua Viva Fresh Sh.p.k ndërhyrja rrënimi i pjesëve të objekteve të kategorisë së II-të, me destinim objekte industriale dhe depo, të cilat gjenden në rrugën "Gjergj Sokoli – Papa Klementi" në parcelat kadastrale me numër: 4341-1, 43-42-1, 43-46-1, 43-47-0, ZK: Gjakovë –J-Qytet, me qëllim të evitimit të rrezikut të shembjes së kulmit, për shkak të gjendjes ekzistuese faktike, e cila referuar raportit me nr.4917, nr.Fq.2, i datës 23.11.2022, i rekomanduar sipas Vendimit me Nr.Ref.BD-173/67, dt.20.11.2022, nga Bordi i Drejtorëve i AKP-së, i lëshuar nga projektuesi Guri-ds, Sh.p.k Prishtinë, me investitor Viva Fresh Sh.p.k për AKP-në, rezulton të jetë me trarë të kalbur, me shtylla-trarë konstruktive që kanë humbur aftësinë mbajtëse të tyre.

64. Më 23 mars 2023, parashtruesja e kërkesës parashtroi ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kundër Vendimit [Nr.07/351/02-914] të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Gjakovës, me të cilin i ishte dhënë leja e rrënimit Viva Fresh Sh.p.k.

65. Më 11 korrik 2023, parashtruesja e kërkesës dorëzoi një padi për anulimin e kontratës së datës 8 gusht 2022 për demontimin e makinerisë si dhe shitjen e tyre, rrënimin e objekteve dhe infrastrukturës, ndërtimin e qendrës tregtare afariste, si dhe propozoi caktimin e masës së sigurimit për ndalimin e ekzekutimit të kontratës në fjalë, dhe kërkoi bashkimin e kësaj padie me dy paditë e tjera paraprake. Parashtruesja e kërkesës kishte deklaruar se nuk është konsultuar dhe njoftuar nga AKP-ja për veprimet e marra në lidhje me emërimin e koordinatorit, rrënimin e objekteve dhe ndërtimin e Qendrës Tregtare "Viva Fresh" sipas vendimeve të AKP-së. Tutje, parashtruesja e kërkesës ka kërkuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së që t shqyrtojë kontratën dhe vendimet e marra nga "Viva Fresh" si dhe ka paralajmëruar ushtrimin e padisë, përkundër faktit të ekzistimit të kësaj padie. Sipas parashtrueses së kërkesës, pasi statusi juridik ende nuk është caktuar, është e qartë se as

AKP nuk ka të drejtë të disponojë me asetet e parashtrueses së kërkesës dhe se këto veprime përbëjnë vepër penale, si dhe për këtë arsye i njëjti ka bërë kallëzim penal më 27 shtator 2022 në Prokurorinë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë dhe Prokurorinë Speciale në Prishtinë.

66. Më 11 shtator 2023, është mbajtur seanca dëgjimore publike, në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesi i parashtrueses së kërkesës dhe AKP-ja. Parashtruesja e kërkesës deklaroi se ndërmarrja është vënë në administrimin e AKP-së dhe objektet e saj së bashku me pajisjet kanë filluar të demolohen dhe shkatërrohen. Për të argumentuar këto fakte, janë ofruar foto për ta dëshmuar gjendjen, si dhe pretendoi se kushtet për caktimin e masës së përkohshme janë plotësuar, pasi që objekti është shkatërruar tërësisht dhe se aty më nuk do të ketë fabrikë për shitje, por vetëm tokë ndërtimore, në të cilën kontraktuesi ka filluar të ndërtojë objekte për qëllime komerciale. AKP-ja e kundërshtoi kërkesën e parashtrueses dhe theksoi se objekti i NSH-së ka filluar të shkatërrohet pasi çatia ka pikur, andaj rrënimi është bërë nga organi administrativ i Komunës, pasi që kishte paraqitur rrezik. Kjo u vërtetua edhe nga Komuna e Gjakovës, e cila ka lejuar rrënimin e pjesëve të objekteve të kategorisë së II-të – Objekti Industrial dhe depo, të cilat gjenden në rr. "Gjergj Sokoli" në ngastrat nr.43412-1, 4342-1, 4346-1, 4347-0, ZK Gjakovë, me qëllim të evitimit të rrezikut të shembjes së kulmit, pasi rezultoi që objekti të jetë me shtylla të kalbura dhe që kanë humbur aftësinë mbajtëse të tyre. Vendimi i AKP-së i datës 30 nëntor 2022 është lëshuar bazuar në këtë konstatim, dhe bordi i drejtorëve me rastin e marrjes së këtij vendimi kishte kërkuar nga qiramarrësi deponimin e mjeteve në shumën 186.522,00 euro si garancion bankar, në rast se ndërpritet kontrata e qirasë dhe të njëjtit nuk do t'i kthehen këto mjete në rast se nuk e kthen në gjendjen ekzistuese.

67. Më 12 shtator 2023, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i ktheu përgjigje parashtrueses së kërkesës ku theksoi se Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Gjakovës është e obliguar për zhvillimin e procedurës administrativo-juridike, gjegjësisht për vendosje me akt administrativ lidhur me këtë çështje.

68. Më 5 tetor 2023, DHPGJSK përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, me të cilën kërkonte t'i ndalohet të padituris AKP-së të lidhë kontrata dhe të rrënojë objekte dhe të ndërtojë në dëm të paditësit, respektivisht t'i ndalohet të zbatojë vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. DHPGJSK ndër të tjera arsyetoi se " *Gjykata në bazë të provave që palët ndërgjyqës kanë dorëzuar, ka vërtetuar faktin se AKP-ja, Bordi i Drejtorëve, me Vendimin saj BD ref.97/16, dt.25.09.2017, e ka vuar nën administrim direkt, NSH-në "Metaliku – Fabrika e Enëve" Gjakovë, dhe pa paragjykuar meritat e padisë për çështjet statusore dhe të padisë për anulimin e Vendimit të cekur të Bordit të AKP-së, dt.25.09.2017, derisa sa të vendoset për çështjen meritore, AKP-ja sipas nenit 5 të Ligjit nr. 04/L-034, ka kompetencë ligjore për të administruar me NSH-të, sikundër edhe në rastin konkret. Gjykata vlerëson se në rastin konkret Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme me Aktvendimin e saj SCC-08-0243, më dt.23.09.2011 e i cili Aktvendim është vërtetuar me Aktvendimin e Kolegjit ASC-112-0088, më dt. 04.03.2015, janë siguruar asetet të mos shiten deri në përfundimin e kontestit në lidhje me statusin e ndërmarrjes, dhe se veprimet e AKP-së, Bordit të Drejtorëve me Vendimin e saj ref.BD156/5, dt.23.12.2021, janë në kuadër të autorizimeve ligjore dhe kompetencave të saja në lidhje me administrimin e pronës në fjalë. Gjykata në bazë të deklarimit të kundërshtarit të sigurimit, ka vërtetuar faktin se deri te rrënimi i objektit ekzistues ka ardhur si rezultat i konstatimit të rrezikut për rrethin (mjedisin) si pasojë gjendjes jo të qëndrueshme dhe se*

për këtë është zhvilluar një procedurë administrative. Gjykata vlerëson se Bordi i drejtorëve me rastin e marrjes së Vendimit dt.30.11.2022, është siguruar përmes garancionit me shumë 186,522.00 e, për të mbuluar dëmin e supozuar.
Në rastin konkret për dëmin eventual si pasojë e rrënimit nga AKP është marrë veprimi i sigurimit me garancion bankar dhe se me këtë veprim edhe dëmi i supozuar mund të kompensohet. Gjykata vlerëson se dhënia me qira e paluajtshmërisë të kontraktuesi " Viva Fresh sh.p.k, nuk paraqet ndonjë veprim të dëmshëm dhe tejkalim të autorizimeve që ka AKP, sepse këto veprime kanë për qëllim të rrisin qëndrueshmërinë financiare të ndërmarrjes deri sa të vendoset statusin. Gjykata vlerëson se në rastin konkret propozimi i propozuesit në lidhje me caktimin e masës së sigurimit nuk mbështetet për faktin se nuk është plotësuar kushti i dytë, që kërkohet dëmi është i pariparueshëm, sepse siç u cek më lartë, gjendja mund të rikthehet dhe dëmi i supozuar mund të evitohet".

69. Më 23 tetor 2023, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër Aktvendimit [SCC-08-0243] të 5 tetorit 2023 të DHPGJSK-së, duke propozuar që i njëjti të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesa për caktimin e masës së sigurimit, ose aktvendimi i ankimuar të prishet dhe që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Parashtruesi i kërkesës theksoi se ishte i sigurt që në kontratën mes AKP-së dhe "Viva Fresh" ka veprime të kundërligjshme, dhe se e njëjta është bërë për t'iu shmangur masës së përkohshme të vendosur nga DHPGJSK më 23 nëntor 2011, duke pretenduar se AKP-ja synon ta shesë fabrikën, si dhe ripërsëriti argumentet e dhëna para shkallës së parë.

70. Më 9 nëntor 2023, Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001], (i) refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtrueses së kërkesës; (ii) vërtetoi Aktvendimin e Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së [SCC-08-0243] të datës 5 tetor 2023; (iii) parashtresa e ndërhyrësit hedhet poshtë si e papranueshme; (iv) nuk caktohet taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore. Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së arsyetoi se pretendimet e parashtrueses së kërkesës se AKP-ja përmes procedurave të shfrytëzimit dhe dhënies me qira ka për qëllim ta shesë këtë fabrikë nuk qëndrojnë, pasi është e mbrojtur me aktvendim të formës së prerë të DHPGJSK-së. Ndërsa, sa i përket propozimit për masë të sigurimit, Kolegji i Apelit u pajtua në tërësi me gjetjet dhe konstatimet e shkallës së parë të DHPGJSK-së, si dhe me arsyetimin lidhur me refuzimin e kësaj kërkese ku ndër të tjera theksoi se: "*Megjithatë nuk mund të lejohet gjendja e status quos në këtë fabrikë, me objekte aq të vjetërsuara që paraqesin rrezik për njerëzit dhe ambientin dhe nuk mund të lihet si pronë e askujt, sepse atëherë nuk do të kishte dobi as parashtruesi i kërkesës as AKP, por do të keqpërdorohej nga personat tjerë. Për këto arsye veprimet dhe vendimet e AKP-së janë të këtij karakteri, që të shfrytëzohet aq sa mundet kjo hapësirë, por duke mos ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të shitjes së pronës kontestuese. Në fund të fundit, bazuar në nenin 5 të Ligjit mbi AKP-në, Agjencia ka obligim mirëmbajtjen e këtyre pronave dhe rritjen e vlerës së tregut. Nëse paditësi do të del fitues i së drejtës së pretenduar, kthimi në gjendjen e mëparshme dhe mbulesa e humbjeve është shumë e lehtë. Për këto arsye, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar dhe rrjedhimisht vërtetohet aktvendimi i ankimuar i Kolegjit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së si i drejtë dhe i bazuar në ligj*".

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

71. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenin 1 të protokollit nr.1 dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

72. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, duke aluduar në kohëzgjatjen e procedurës gjyqësore, pasi që padinë e kishte parashtruar më 4 gusht 2008 në DHPGJSK dhe se kjo gjykatë ende nuk kishte vendosur në merita për rastin në fjalë. Lidhur me këtë pretendim, parashtruesja e kërkesës thekson se " *Në këtë çështje kontesti është me dt.04.08.2008. Masa e sigurisë është caktua me Aktvendimin SCC-08-0243 dt.23 shtator 2011. Pastaj fjetje, heshtje , mosveprim. I vetmi angazhim ka qenë refuzimi i kërkesave tona për pengim të AKP që të shkel të drejtat tonë, me vendime joligjore që shkelin të drejtat tona duke shkelur të drejtat tona kushtetuese dhe të drejtat themelore kushtetuese*".

73. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon se AKP-ja në esencë nuk ka respektuar masën e përkohshme të miratuar nga DHPGJSK përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] të 23 shtatorit 2011, dhe të vërtetuar nga Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [ASC-11-088-A0001] të 4 marsit 2015, pasi që " *AKP në përpjekje që të gjenë rrugë që të disponojë me Fabrikën e Enëve, së pari ka shkarkuar Bordin drejtues legjitim dhe legal dhe ka vendosur masat e menaxhimit të drejtë për drejtë, që krijojnë një asocon me veprimet të pushtetit në kohë të kaluara. AKP ka caktua një udhëheqje jo profesionale dhe lojale dhe dobësi tjera, e cila Fabrikës së Enëve i ka shkaktua dëme. Në atë bazë të krijuar, AKP lidhë me Viva Fresh kontratë për qira, në kohëzgjatje prej 1 viti*".

74. Parashtruesja e kërkesës tutje pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së është dashtë të mbajë seancë dëgjimore, pasi që sipas parashtrueses së kërkesës " *Kolegji ankimorë nuk ka shqyrtuar të gjitha parashtrimet ankimore. Para së gjithash konsideroj se nuk janë plotësuar kushtet që çështja të procedohet pa seancë dëgjimore ... me nenin 306 të LPK-së është përcaktuar se me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit*". Sipas parashtrueses së kërkesës, pamundësimi i mbajtjes së seancës dëgjimore paraqet shkelje të së drejtës për qasje në drejtësi. Lidhur me këtë, ajo i referohet disa rasteve të Gjykatës: KI44/21, KI145/19, KI146/19, KI/147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI 156/19, KI157/19, KI159/19, etj.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës

75. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktvendimi [AC-I-23-0613-A0001] i 9 nëntorit 2023 i Kolegjit të Apelit i DHPGJSK-së i shkel të drejtat pronësore të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, të aksionarëve të Fabrikës së Enëve "ENA", duke qenë se e njëjta është shoqëri aksionare, dhe asetet e tyre janë privuar nga prona dhe vazhdojnë të dëmtohen. Parashtruesja e kërkesës thekson se "*Në atë bazë të krijuar, AKP lidhë kontratë me Viva Fresh për qira, në kohëzgjatje prej një viti. Akti i tillë është shkelje e vrazhdë ligjit dhe dispozitave normative me dashje, e shkel të drejtat elementare të parashtrueses së kërkesës dhe punëtoreve të saj. Faktikisht, caktohet refuzohet propozimi për caktim të masës së sigurisë dhe me këtë mundësohet vuarja në lojë e ligjit, kështu që lidhet kontrata për qiranë njëvjeçare, në bazë të së cilës qiramarrësi, në koordinim me AKP e demonton dhe pajisjen e një Fabrike me traditë mbi 50 vjeçare, duke dëmtuar ato, duke rrënuar pjesën më të madhe. Pasi që ka rrënuar një pjesë të madhe të Fabrikës, ka ndërtuar në*

oborrin e Fabrikës objekt shumë të madhe për aktivitetin tregtar të Viva Fresh-it. Gjatë seancës dëgjimore dhe në parashtresa është propozuar Kolegjit të shkallës së parë që të bëjë vendshiqimin në vend dhe të konstatoj gjendjen dhe se veprimet që janë ndërmarrë nuk janë veprime një vjeçare por ajo kontratë është bishterim i ligjit dhe angazhim për përpjekje që të privohen aksionet nga prona e tyre. Kundër aktvendimit të shkallës së parë SCC-08-0243 të dt. 5 tetor 2023 është paraqitur ankim Kolegjit të Apelit të DHPGJSK. Kolegji ankimorë nuk ka shqyrtuar të gjitha parashtrimet ankimore".

76. Më tej, parashtruesja e kërkesës thekson se " *objekt i atakimit me këtë kërkesë është shkelja nga DHPGJSK të së drejtës në proces të drejtë dhe korrekt për arbitraritet që për pasojë ka pasë shkelje e të drejtave fundmentale të njeriut për parashtruesen e kësaj kërkese dhe punëtorëve si dhe shkelje e të drejtës në gjykim në afat të arsyeshëm, si dhe shkelje e të drejtës e të drejtave pronësore të subjektit personit juridik parashtrues i kësaj kërkese dhe punëtorëve të saj*".

77. Në fund, parashtruesja e kërkesës nga Gjykata kërkon që: (i) ta deklarojë kërkesën e pranueshme; (ii) të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 dhe 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të protokollit nr.1 dhe 6 të KEDNJ-së; (iii) ta shpallë të pavlefshëm aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së.

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*
   [...]

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. *E drejta e pronës është e garantuar.*

2. *Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.*

3. *Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëj ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohet.*

4. *Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë ekspropriimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.*

5. *Prona intelektuale mbrohet me ligj.*

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1
(Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cënojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

LIGJI NR. 06/L-086
PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 61
(Masat e sigurimit)

1. Pas parashtrimit të propozimit nga njëra palë, Dhoma e Posaçme mund të caktojë një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi jep prova të besueshme për ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij dhe se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i "pariparueshëm" vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Propozimi për caktimin e masës së sigurimit duhet dorëzuar së bashku me kërkesën, ose nëse dorëzohet pas parashtrimit të një kërkesë/padie, atëherë ajo duhet t'i referohet asaj kërkese/padie.
[...]"

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 69
Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkese për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
2. Gjatë seancës dëgjimore me gojë, Kolegji i Apelit kryesohet nga gjyqtari kryesues. Kryesuesi është përgjegjës për mbarëvajtjen e seancës. Në fillim të çdo seance dëgjimore, Kryesuesi përcakton praninë e palëve dhe avokatëve të tyre.
3. Pala që përfaqësohet në seancë përmes avokatit, mund t'i drejtohet Kolegjit të Apelit vetëm përmes atij, përveç nëse ndonjë anëtar i Kolegjit të Apelit ia parashtron asaj pale një pyetje drejtpërdrejt
4. Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe çfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjës, për të cilin pala pretendon se është "qartazi i pasaktë".
5. Në dëgjimin me gojë, palëve mund t'u jepet mundësia për të bërë një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla.
6. Përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë në bazë të nenit 70 të këtij ligji, gjyqtari(ët) nuk do të nis procedurat për vlerësimin e provave.
7. Procesmbajtësi kujdeset që procesverbali fjalë-për-fjalë i të gjitha seancave mbahet dhe regjistrohet nga raportuesi i gjykatës. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryesuesi.

LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
DETYRAT DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË

Neni 5
Ndërmarrjet dhe asetet nën autoritetin administrativ të agjencisë

1. Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administrojë:
1.1.ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo;
1.2.të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 Marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas paragrafi 2. të këtij neni; dhe

1.3.të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji; dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit.
2. Nëse një rregullore ose ligj që është në fuqi dhe që është shpallur nga një autoritet kompetent publik në Kosovë pas 10 Qershorit 1999 i cakton përgjegjësinë për administrimin e aseteve të përcaktuara në nën-paragrafi 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni një organi tjetër publik, Agjencia nuk do të ketë autoritet mbi këto ndërmarrje duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të atij ligji ose rregullore.
3. Autoriteti administrativ i Agjencisë i paraparë në nenin 5 paragrafi 1.1. do të vlejë për të gjitha pronat në pronësi apo posedim të ndërmarrjes, përfshirë pronat që gjenden jashtë Kosovës; me kusht që - dhe pavarësisht nga detyrimet e Agjencisë të përcaktuara në nenin 2 paragrafi 1 - lidhur me ato prona që gjenden jashtë Kosovës, Agjencisë i kërkohet vetëm të ushtrojë 6 autoritetin e vet mbi ato prona deri në masën që Agjencia e konsideron të arsyeshme, duke marrë parasysh vlerën dhe qasjen ndaj këtyre pronave dhe kufizimet e burimeve administrative të Agjencisë siç referohen në nenin 7.1. të këtij ligji. Gjatë vendimmarrjes mbi këto çështje, Agjencia merr parasysh të gjitha politikat përkatëse të cilat mund të miratohen nga Qeveria ose Kuvendi i Kosovës.
4. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas paragrafit 1. dhe 2. të këtij neni si dhe neneve 6, 8 ose 9 të këtij ligji, përveç nëse:
4.1.transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi;
4.2.janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me Transformimin, qofshin ato që kanë dalë gjatë apo pas Transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate – përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe 4.3.transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,
5. Gjatë ushtrimit të të drejtave dhe kompetencave të saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji në lidhje me një ndërmarrje e cila i është nënshtruar transformimit, Agjencia ka të drejtë të supozojë se transformimi nuk i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4. të këtij neni, përveç nëse Agjencia ka në dispozicion prova bindëse të gatshme të cilat vërtetojnë se transformimi i përmbush këto kushte. Në raste të këtilla zbatohet paragrafi 6. të këtij neni.
6. Nëse, në përputhje me paragrafin 5. të këtij neni, Agjencia konstaton se Transformimi i një ndërmarrje ose aseti i përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 4, dhe Agjencia nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim më parë sa i përket ndërmarrjes së tillë apo ndonjë aseti të saj sipas nenit 6.2. të këtij ligji, zbatohen rregullat në vijim:
6.1.nëse agjencia ka prova të qarta të gatshme në dispozicion, të cilat në mënyrë bindëse e bëjnë ndarjen e të drejtave (ose pronësisë) të aksionarëve mbi ndërmarrjen, ndërmjet kapitalit shoqëror (ose pronësisë) dhe kapitalit privat (ose pronësisë), Agjencia do ta ndërpresë ushtrimin e autoritetit mbi këtë ndërmarrje përveç për qëllime të ushtrimit të të gjitha të drejtave të aksionarit (ose pronësisë) që dalin nga kapitali në pronësi shoqërore (pronësi) mbi një pjesë të kapitalit të përgjithshëm të ndërmarrjes, që përfshinë të drejtën për të shitur ato të drejta të aksionarit (pronësisë); dhe
6.2.në mungesë të këtyre provave, për ato ndërmarrje Agjencia do të vazhdojë të ushtrojë të drejtat dhe kompetencat e saj sipas neneve 6, 8 dhe 9 të këtij ligji.

7. Të gjitha çështjet që ndërlidhen me apo që shfaqen në lidhje me likuidimin e një ndërmarrje apo korporate nën autoritet të agjencisë sipas nenit 6, paragrafi 2.1. të këtij ligji, përfshirë, mes tjerash, përcaktimin e vlefshmërisë së çdo pretendimi të bërë nga një kreditor i supozuar apo çdo pohim për barazi në interesat e pronësisë i bërë nga një pronar i supozuar dhe përcaktimin e shpërndarjes së duhur së të ardhurave të kreditorëve dhe pronarëve, janë përgjegjësi të autoritetit përkatës të likuidimit, i cili respekton rregullat e përcaktuara në Shtojcën 1 të këtij ligji. Çdo person që parashtron një pretendim apo pohon një interes të tillë i cili nuk pajtohet me përcaktimin e autoritetit të likuidimit që prekë atë pretendim apo interes të pohuar, ka të drejtën që t'i sfidojë ato përcaktime pranë Dhomës së Posaçme duke iu përmbajtur kërkesave procedurale të parapara në nenin 37.7 të Shtojcës 1 të këtij ligji.

Pranueshmëria e kërkesës

78. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

79. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."
[...]

80. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

81. Gjykata fillimisht vëren se në pajtim me paragrafin 4 të nenit 21 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, të vlefshme për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.,* Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, me parashtrues *"Bayerische Versicherungsverbrand",* Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).

82. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht…".

83. Përkitazi me përmbushjen e kritereve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës: është palë të autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; e kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-23-0613-A0001] e 9 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së; se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; se i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e kanë parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.

84. Në vijim dhe me qëllim të vlerësimit të kritereve tjera të pranueshmërisë, Gjykata fillimisht rikujton se parashtruesja e kërkesës në kërkesën e saj pretendon shkeljen e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë, përkatësisht me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

85. Gjykata së pari do të vazhdojë me vlerësimin e pretendimit të parashtrueses për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për të vazhduar më tej me pretendimin e parashtrueses për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së.

86. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë nëse në rrethanat e rastit konkret janë të aplikueshëm neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe neni 46 i Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Përkatësisht, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesa e parashtrueses së kërkesës, e cila ndërlidhet me procedurën paraprake gjyqësore për aprovimin e kërkesës së parashtrueses të kërkesës nga Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së që ndërlidhet me lëshimin e masës së përkohshme të sigurisë, duke i ndaluar në rastin konkret AKP-së të ndërmarrë çfarëdo veprimi për shitjen, tjetërsimin, dhënien me qira apo demontimin e fabrikës deri në një vendim përfundimtar nga Kolegji i Apelit, në kuptim të pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtës së saj në pronë është *ratione materiae* me Kushtetutën.

Lidhur me zbatueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në procedurën paraprake

87. Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, duke marrë parasysh që vendimet e kontestuara ndërlidhen me vendimet përkitazi me masën e sigurisë, përkatësisht "*procedura paraprake*", Gjykata bazuar në praktikën e saj gjyqësore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ), duhet të vlerësojë aplikueshmërinë e garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet pikës (b) të paragrafit (3) të rregullit 34 të Rregullores së punës, sipas së cilës, Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse e njëjta nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

88. Prandaj, në kontekst të kësaj të fundit, vlerësimi i këtij kriteri në rrethanat e rastit konkret është i rëndësishëm, sepse procedurat e zhvilluara para gjykatave të rregullta hyjnë në fushëveprimin e "*procedurave paraprake*", përkatësisht Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, me të cilin refuzohet ankesa e parashtrueses së kërkesës kundër aktvendimit të Kolegji i Specializuar me të cilin ishte refuzuar kërkesa për masë të sigurisë me të cilën kërkonte t'i ndalohet të paditurës AKP-së të lidhë kontrata dhe rrënojë objekte dhe të ndërtojë në dëm të saj, derisa padia për shqyrtim në merita është ende në shqyrtim e sipër në Kolegjin e Specializuar të DHPGJSK-së. Rrjedhimisht, Gjykata do të vlerësojë nëse neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është i zbatueshëm në rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës.

89. Në këtë kontekst specifik, Gjykata vëren se çështja e aplikueshmërisë së nenit 6 të KEDNJ-së në procedura paraprake është interpretuar nga GJEDNJ-ja përmes praktikës së saj gjyqësore, në harmoni me të cilën Gjykata, në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës, është e obliguar të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

90. Gjykata vë po ashtu në dukje se kriteret për aplikueshmërinë e nenit 31 të Kushtetutës përkitazi me procedurat paraprake janë përcaktuar po ashtu edhe në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI195/20, me parashtrues *Aigars Kesengfelds*, Aktgjykim i 29 marsit 2021; KI 75/21, me parashtrues "*Abrazen LLC", "Energy Development Group Kosova LLC", "Alsi & Co. Kosovë LLC" dhe "Building Construction LLC"*, Aktgjykim i 19 janarit 2022; KI202/21, me parashtrues *Kelkos Energy SH.P.K.*, Aktgjykim i 29 shtatorit 2022; dhe KI143/22 me parashtrues *Hidroenergji sh.p.k.,* Aktgjykim i 15 dhjetorit 2022. Parimet e përgjithshme të aplikuara nga Gjykata në vendimet e lartcekura janë bazuar në rastin e GJENDJ-së, Micallef kundër Maltës, nr. 17056/06, Aktgjykim i 15 tetorit 2009.

91. Bazuar në praktikën gjyqësore të saj dhe të GJEDNJ-së, Gjykata vëren se jo të gjitha masat e sigurisë apo masat e përkohshme përcaktojnë të drejtat ose detyrimet civile dhe në mënyrë që neni 6 i KEDNJ-së të konsiderohet i zbatueshëm, GJEDNJ-ja përcaktoi kriteret mbi bazën e të cilave duhet të vlerësohet aplikueshmëria e nenit 6 të KEDNJ-së në "proceduarat paraprake" (shih rastin e GJEDNJ-së, Micallef kundër Maltës, cituar më lart, paragrafët 83-86).

92. Rrjedhimisht, për të konstatuar nëse në rastin konkret aplikohet neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, Gjykata do t'u referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës për sa i përket aplikueshmërisë

së garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së dhe më pas të njëjtat do t'i aplikojë në rrethanat e rastit konkret.

93. Sipas kritereve të përcaktuara në rastin *Micallef kundër Maltës*, të cilat kritere edhe kjo Gjykatë i ka pranuar përmes praktikës së vet gjyqësore:

(i) së pari, e drejta në fjalë duhet të jetë *"civile"* në kuptim të KEDNJ-së, si në shqyrtimin gjyqësor, ashtu edhe në procedurat lidhur me masën e sigurisë, brenda kuptimit autonom të këtij nocioni sipas nenit 6 të KEDNJ-së; dhe

(ii) së dyti, kjo procedurë duhet të përcaktojë në mënyrë efektive të drejtën civile përkatëse. Sa herë që një masë e përkohshme mund të konsiderohet efektive për të përcaktuar të drejtën civile ose detyrimin në fjalë, pavarësisht nga kohëzgjatja që është në fuqi, neni 6 do të jetë i zbatueshëm (shih në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, Micallef kundër Maltës, cituar më lart, paragrafët 84 dhe 85 dhe referencat e përmendura aty).

94. Lidhur me rastin konkret, Gjykata rikujton se esenca e rastit ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për vendosjen e masës së sigurisë në pronat kontestuese nga ana e Kolegjit të Apelit, duke aprovuar vendimin e shkallës së parë, përmes të cilit ishte refuzuar kërkesa e parashtrueses për vendosjen e masës së sigurisë lidhur me ndërhyrjen në pronat kontestuese deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga DHPGJSK. Rrethanat e rastit konkret rezultojnë nga ajo se, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar disa padi kundër AKP-së. Në padinë e parë, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar njohjen e statusit të shoqërisë aksionare, si dhe kishte propozuar lëshimin e masës së përkohshme, që të ndalohet AKP-ja që ta shesë ndërmarrjen. DHPGJSK kishte vendosur ta miratojë kërkesën për lëshimin e masës paraprake të sigurisë dhe i ndaloi AKP-së shitjen e aseteve të hedhura për privatizim të New Co Metaliku Ena, Sh.a., i cili vendim ishte vërtetuar edhe nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, pra vendimi ishte bërë i formës së prerë. Në padinë e dytë, parashtruesja e kërkesës kërkoi ndalimin e vendosjes së ndërmarrjes nën menaxhimin e AKP-së, ku edhe këtu nga gjykata kërkoi vendosjen e masës së përkohshme, e cila masë u vendos nga ana e DHPGJK-së, i cili vendim u ndryshua nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së. Parashtruesja e kërkesës kërkoi përsëritjen e procedurës, e cila kërkesë iu refuzua nga ana e Kolegjit të ankesave të DHPGJSK-së. Më tej, parashtruesja e kërkesës parashtroi padi kundër AKP-së dhe kërkoi nga gjykata që të lëshojë masë të përkohshme të sigurimit lidhur me vendimin e AKP-së për demontimin dhe rrënimin e objekteve të ndërmarrjes. DHPGJSK e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, me të cilën kërkonte t'i ndalohet të paditurës AKP-së të lidhë kontrata dhe të rrënojë objekte dhe të ndërtojë në dëm të paditësit, respektivisht t'i ndalohet të zbatojë vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Vendimi i DHPGJSK-së u vërtetua edhe nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së.

95. Parashtruesja e kërkesës para Gjykatës konteston Aktvendimin [AC-I-23-0613-A0001] e 9 nëntorit 2023 të Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, duke pretenduar se ky i fundit me rastin e refuzimit të ankesës kundër vendimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJSK-së, me të cilin ishte refuzuar kërkesa për masë të sigurisë, kishte shkelur të drejtën e parashtrueses të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës.

96. Në ndërlidhje me si më sipër, Gjykata vëren se thelbi i së drejtës në fjalë në procedurë kryesore (të shqyrtimit të meritave) ndërlidhet me pretendimin se parashtrueses së kërkesës i takon e drejta që të regjistrohet ndërmarrja si shoqëri aksionare dhe jo të menaxhohet nga AKP-ja. Pra, parashtruesja e kërkesës ka pretendime se menaxhimi i

ndërmarrjes u takon punëtorëve dhe jo AKP-së dhe se kjo e fundit nuk ka të drejtë të ndërhyjë në pronat e fabrikës, pra e drejta për të cilën pretendojnë ka të bëjë me një të drejtë "*civile*".

97. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh të drejtën e përfshirë në "*procedurat paraprake*", përkatësisht masën e përkohshme dhe natyrën e saj përcaktuese për të drejtën civile në fjalë, Gjykata konstaton që rrethanat e rastit konkret i përmbushin kriteret për aplikimin e garancive procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

98. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtrueses të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.

99. Në dritën e fakteve dhe argumenteve të paraqitura në këtë kërkesë, Gjykata konsideron se kërkesa e saj ngre çështje serioze kushtetuese, të cilat kërkojnë shqyrtim të meritave të kërkesës. Për më tepër, kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar, brenda kuptimit të rregullit 34 të Rregullores së punës dhe nuk ekziston asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme.

Meritat e rastit

100. Gjykata në vazhdim rikujton edhe një herë pretendimin e parashtrueses përkitazi me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, e cila në thelb para Gjykatës pretendon se: (i) si rezultat i kohëzgjatjes së procedurave përkitazi me vendosjen në merita në lëndën [SCC-08-0243), asaj i është shkelur e drejta për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së; (ii) si rezultat i moszbatimit të masës së përkohshme të nxjerrë nga DHPGJSK përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] të 23 shtatorit 2011, e cila kishte miratuar kërkesën për lëshimin e masës paraprake dhe i ndaloi AKP-së shitjen e aseteve të hedhura për privatizim të New Co Metaliku Ena, Sh.a., nga dita e dorëzimit të këtij Aktvendimi, dhe kjo masë vendosi të mbetet në fuqi deri në vendimin përfundimtar të padisë nga DHPGJSK-ja, asaj i është shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht parimi i sigurisë juridike. Parashtruesja e kërkesës po ashtu pretendon shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

101. Nga si më sipër, Gjykata, fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së sa i përket të drejtës për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm. Për këtë qëllim, në vijim Gjykata fillimisht (i) do t'i shtjellojë parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm, siç është e garantuar përmes neneve të lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së; dhe më pas, (ii) do t'i aplikojë të njëjtat në rrethanat e rastit konkret. Gjykata po ashtu do t'i shqyrtojë pretendimet përkitazi me moszbatimin e masës së përkohshme, përkatësisht mosrespektimin e formës së prerë të vendimeve të mëparshme të DHPGJSK-së dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së, duke shtjelluar parimet e përgjithshme dhe duke aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

Pretendimet lidhur me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

Sa i përket pretendimit për një vendim gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm

(i) Parimet e përgjithshme

102. Gjykata rikujton se, bazuar në praktikën e Gjykatës, por edhe të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastin e GJEDNJ-së *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50; dhe rastet e Gjykatës KI127/15, parashtrues *Mile Vasović*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 qershorit 2017; KI19/17, parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 shkurtit 2018).

103. Në përllogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës, merret për bazë e gjithë procedura në tërësi, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit (shih rastin e GJEDNJ-së *Konig kundër Gjermanisë*, nr. 6232/73, Aktgjykim i 28 qershorit 1978, paragrafi 98). Procesi gjyqësor konsiderohet i përfunduar në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga instanca e fundit gjyqësore (shih rastet e GJEDNJ-së *Eckle kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 74; *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50 dhe rastin e Gjykatës KI177/19, parashtrues *NNT "Sokoli"*, Aktgjykim i 29 marsit 2021).

104. Ekzekutimi i një vendimi gjyqësor konsiderohet pjesë integrale e gjithë procedurës dhe përfshihet në përllogaritjen e kohës së zgjatjes së asaj procedure (shih rastin e GJEDNJ-së *Martins Moreira kundër Portugalisë*, nr. 11371/85, Aktgjykim i 26 tetorit 1988, paragrafi 44). Përllogaritja e kohëzgjatjes së procedurës nuk ndërpritet deri në momentin kur e drejta e fituar bëhet efektive (shih rastin e GJEDNJ-së *Estima Jorge kundër Portugalisë*, nr. 24550/94, Aktgjykim i 21 prillit 1998, paragrafët 36-38).

A. Parimet e përgjithshme të kohëzgjatjes së procedurës

105. Gjykata rikujton se është detyrim i shtetit që ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të tillë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilit për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati te arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së *Comingersoll kundër Portugalisë*, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 24; *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 142).

106. Gjykata rikujton se administrimi i drejtësisë pa vonesa është shumë i rëndësishëm për të mos e rrezikuar efikasitetin dhe kredibilitetin e sistemit të drejtësisë (shih rastin e GJEDNJ-së *Scordino kundër Italisë* (nr.1), nr. 36813, Aktgjykim i 29 marsit 2006, paragrafët 224-225). Zgjatja e tepruar e administrimit të drejtësisë përbën një nga rreziqet kryesore kundër sundimit të ligjit. Kur shkeljet në lidhje me zgjatjen e procedurave gjyqësore bëhen të shpeshta dhe nuk janë raste të izoluara, atëherë akumulimi i këtyre shkeljeve përbën një praktikë e cila nuk është në përputhje me KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së *Bottazzi kundër Italisë*, nr. 34884/97, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 22).

107. Arsyeshmëria e zgjatjes së një procesi gjyqësor duhet të vlerësohet duke u bazuar në rrethanat përkatëse të secilit rast (shih rastin e GJEDNJ-së *Frydlender kundër Francës*, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43). Vlerësimi për arsyeshmërinë e zgjatjes së procedurave gjyqësore duhet të bëhet mbi bazën e karakteristikave të një rasti:

për shembull, në çështjen e ndarjes së trashëgimisë ndërmjet pasardhësve të një personi të vdekur, që zgjati më shumë se 22 vite (shih rastin e GJEDNJ-së *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 6 shtatorit 2021, paragrafët 471, 54-55).

108. Arsyeshmëria e zgjatjes së procedurës gjyqësore matet duke u bazuar në këto kritere kryesore: kompleksiteti i rastit, sjellja e palës, sjellja e autoriteteve shtetërore, dhe rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontestin gjyqësor (shih rastet e GJEDNJ-së *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, nr. 41720/13, Aktgjykim i 25 qershorit 2019, paragrafi 209).

Kriteret e vlerësimit të arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

Kompleksiteti i rastit

109. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i rastit mund të ndërlidhet me çështjet faktike dhe ligjore; me përfshirjen e disa palëve në procedurë; me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta; apo edhe me një numër më të madh të raporteve të ekspertëve që kërkohen (shih rastet e GJEDNJ-së *Papachelas kundër Greqisë*, nr. 31423/96, Aktgjykim i 25 marsit 1999; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, nr. 12539/86, Aktgjykim i 27 tetorit 1994, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 9580/81, Aktgjykim i 8 korrikut 1987, paragrafi 72; *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 210).

110. Edhe në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund ta vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

Sjellja e palës

111. Sipas GJEDNJ-së, neni 6 i KEDNJ-së nuk kërkon nga pala bashkëpunim aktiv me autoritetet gjyqësore, e as nuk mund të fajësohet për përdorimin e mjeteve juridike sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, autoritetet shtetërore nuk mund të mbahen përgjegjëse nëse këto veprime ndikojnë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 68; dhe *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

112. Nga pala kërkohet vetëm të jetë e vëmendshme në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe të mos përdorë taktika për të shtyrë në favor të tij procedurën (shih rastin e GJEDNJ-së *Union Alemntaria Sanders S.A kundër Spanjës*, nr. 11681/85, Aktgjykim i 7 korrikut 1989, paragrafi 35). Sjellja e palës përbën një fakt objektiv që nuk mund t'i mveshet autoriteteve shtetërore, dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit nëse procedura ishte kryer brenda një periudhe të arsyeshme kohore (shih rastin e GJEDNJ-së *Wiesinger kundër Austrisë*, nr. 11796/85, Aktgjykim i 30 tetorit 1991, paragrafi 57). Vetëm vonesat që i atribuohen shtetit mund të ndikojnë në përcaktimin nëse procedurat nuk kishin përfunduar brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastin e GJEDNJ-së *Humen kundër Polonisë*, cituar më lart, paragrafi 66).

113. Disa shembuj që kanë të bëjnë me sjelljen e palës: mungesa e vullnetit të palës për të dorëzuar shkresat mund të ndikojë në ngadalësimin e procedurës; ndryshimi i shpeshtë i avokatit; përpjekjet për të arritur marrëveshje jashtëgjyqësore; nisja e procedurës para gjykatës që nuk ka juridiksion për çështjen; mungesa e kujdesit në ndërmarrjen e hapave proceduralë (shih rastet e GJEDNJ-së *Vernillo kundër Francës*, nr. 11889/85, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 34; *Konig kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 103; *Pizzetti kundër Italisë*, nr. 12444/86, Aktgjykim i 26 shkurtit 1993, paragrafi 18; *Beaumartin kundër Francës*, nr. 15287/89, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 33; dhe *Keaney kundër Irlandës*, nr. 72060/17, Aktgjykim i 30 prillit 2020, paragrafi 95).

Sjellja e autoriteteve shtetërore

114. Shteti mban përgjegjësi për të gjitha autoritetet: jo vetëm për sistemin gjyqësor, por për të gjitha institucionet publike (shih rastin e GJEDNJ-së *Martins Moreira kundër Portugalisë*, cituar më lart, paragrafi 60). Gjatë vlerësimit nëse procedura është kryer brenda një afati të arsyeshëm kohor, Gjykata duhet ta vlerësojë procedurën në tërësi: përkundër që shteti mund të jetë përgjegjës për defekte të caktuara procedurale, megjithatë kjo nuk e përjashton mundësinë që të ketë vepruar në përputhje me detyrat e veta për ta shqyrtuar rastin në mënyrë të shpejtë (shih rastin e GJEDNJ-së *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 211).

115. Shkaktimi i vonesave nga ndërrimi i shpeshtë i gjyqtarëve nuk e shmang përgjegjësinë e shtetit për kryerjen e procedurave brenda afateve të arsyeshme kohore, sepse është detyrë e shtetit që ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë të përshtatshme (shih rastin e GJEDNJ-së *Lechner dhe Hess kundër Austrisë*, nr. 9316/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 58). Mbingarkesa kronike e lëndëve nuk mund të shërbejë si arsyetim për stërgjatjen e procedurave (shih rastin e GJEDNJ-së *Probstmeier kundër Gjermanisë*, nr. 20950/92, Aktgjykim i 1 korrikut 1997, paragrafi 64). Vonesat e shkaktuara nga reformat që synojnë të përshpejtojnë zgjidhjen e rasteve, po ashtu nuk mund të shërbejnë si arsyetim për stërzgjatje të procedurës, për shkak se është përgjegjësi dhe detyrë e shtetit ta organizojë sistemin e drejtësisë në mënyrë që të shmangë stërzgjatjen e procedurave në rastet e mbetura pa u zgjidhur (shih rastin e GJEDNJ-së *Fisanotti kundër Italisë*, nr. 32305/96, Aktgjykim i 23 prillit 1998, paragrafi 22).

116. Gjykata në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar se gjykatat e rregullta duhet të kenë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që vonesat e stërzgjatura të mos shkaktojnë pasiguri te palët. Gjykatat nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore te tjetra. Në të kundërtën, besimi i publikut ndaj rendit juridik do të rrezikohej (shih rastin e Gjykatës KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 67).

Rëndësia e asaj se çfarë është në rrezik për palën në kontest

117. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ekzistojnë kategori të caktuara të rasteve, të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Shembuj të këtyre kategorive të rasteve përfshijnë:

a) Rastet që ndërlidhen me statusin civil (çështja e divorcit, vërtetimi i atësisë) (shih rastet e GJEDNJ-së *Bock kundër Gjermanisë*, nr. 11118/84, Aktgjykim i 29 marsit 1989,

paragrafi 49; dhe *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, Aktgjykim i 7 shkurtit 2002, paragrafi 44).

b) Rastet që ndërlidhen me kujdestarinë e fëmijëve; me raportin prind-fëmijë; me kujdesin e gjyshërve ndaj fëmijëve, kur këta të fundit kanë mbetur pa kujdesin e prindërve; përgjegjësinë e prindërve dhe të drejtat e kontaktit me fëmijët (shih rastet e GJEDNJ-së *Hokkanen kundër Finlandës*, nr. 19823/92, Aktgjykim i 23 shtatorit 1994, paragrafi 72; *Tsikakis kundër Gjermanisë*, nr. 1521/06, Aktgjykim i 10 shkurtit 2011, paragrafët 64-68; *Paulsen-Medalen dhe Svensson kundër Suedisë*, nr. 16817/90, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 39*; Q dhe R kundër Sllovenisë*, nr. 19938/20, Aktgjykim i 8 shkurtit 2022, paragrafi 80).

c) Rastet që ndërlidhen me kontestet nga marrëdhënia e punës; ankesa kundër largimit nga puna; suspendimi nga puna; transferimi; rikthimi në punë; çështjet që lidhen me pensionin (shih rastet e GJEDNJ-së *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45; *Vocaturo kundër Italisë*, nr. 11891/85, Aktgjykim i 24 majit 1991, paragrafi 17; *Obermeier kundër Austrisë*, nr. 11761/85, Aktgjykim i 28 qershorit 1990, paragrafi 72; *Sartory kundër Francës*, nr. 40589/07, Aktgjykim i 24 shtatorit 2009, paragrafi 34; *Ruotolo kundër Italisë*, nr. 12460/86, Aktgjykim i 27 shkurtit 1992, paragrafi 117; *Borgese kundër Italisë*, nr. 12870/87, Aktgjykim i 26 shkurtit 1992, paragrafi 18).

d) Rastet që ndërlidhen me persona të cilët vuajnë nga "sëmundje të pashërueshme" dhe kanë "pritje të reduktuar të jetëgjatësisë" (shih rastet e GJEDNJ-së *X kundër Francës*, nr. 18020/91, Aktgjykim i 31 marsit 1992, paragrafi 47; dhe *A dhe të tjerët kundër Danimarkës*, nr. 20826/92, Aktgjykim i 8 shkurtit 1996, paragrafët 78-81).

e) Rastet që lidhen me pretendimet për ushtrim të dhunës nga zyrtarët policorë (shih rastin e GJEDNJ-së *Caloc kundër Francës*, nr. 33951/96, Aktgjykim i 20 korrikut 2000, paragrafi 120).

f) Në rastet kur mund të rrezikohet e drejta e edukimit (shih, rastin e GJEDNJ-së *Oršuš dhe të tjerët kundër Kroacisë*, nr. 15766/03, Aktgjykim i 16 marsit 2010, paragrafi 109).

g) Disa raste të tjera nuk kërkojnë vëmendje të shtuar, për shembull, rastet që lidhen me kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidente rrugore, apo rastet që kanë të bëjnë me ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve të personit të vdekur (shih rastet e GJEDNJ-së *Nicolae Virgiliu Tanase kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 213; *Omdahl kundër Norvegjisë*, nr. 46371/18, Aktgjykim i 22 prillit 2021, paragrafi 63-64).

A. Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret

118. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se kohëzgjatja e procedurës gjyqësore lidhur me zgjidhjen e rastit të saj në merita për më shumë se 16 (gjashtëdhjetë) vjet në rastin e saj, ku e njëjta nuk ka kontribuar në zgjatjen e procedurës dhe vetëm ka ndjekur hapat proceduralë, përbën shkelje të parimit të gjykimit "*brenda një afati të arsyeshëm*", e garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së.

119. Rrjedhimisht, në pajtim me parimet dhe kriteret e vendosura përmes kësaj praktike gjyqësore, gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtrueses së kërkesës, Gjykata do të marrë parasysh: (i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes së procedurës në tërësi; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave; dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore.

(i) Periudha që do të merret parasysh

120. Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës së saj, ka vlerësuar se përllogaritja e shtrirjes në kohë të procedurave fillon në momentin kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palëve për vendosjen e një të drejte apo interesi legjitim të pretenduar (shih rastet e GJEDNJ-së *Erkner dhe Hofauer kundër Austrisë*, nr. 9616/81, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 64; dhe *Poiss kundër Austrisë*, nr. 9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50). Ky proces konsiderohet i përfunduar me nxjerrjen e një vendimi gjyqësor përfundimtar nga një instancë kompetente gjyqësore e fundit (shih rastin e GJEDNJ-së *Poiss kundër Austrisë*, cituar më lart, paragrafi 50).

121. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës më 4 gusht 2008 kishte parashtruar në DHPGJSK padi kundër AKP-së, përmes së cilës kërkoi njohje të plotë të statusit të saj si shoqëri aksionare, duke filluar nga vitit 1991, respektivisht nga 29 maji 2003, dhe largimin nga administrimi i AKP-së. Nga shkresat e lëndës rezulton se rasti i parashtrueses së kërkesës ende nuk është vendosur në merita nga ana e DHPGJSK-së.

122. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së, llogaritet nga data e parashtrimit të padisë në DHPGJSK, përkatësisht nga 4 gushti 2008 e deri në momentin e parashtrimit të kërkesës në Gjykatë, periudhë që gjithsej përfshin 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, 5 (pesë) muaj dhe 4 (katër) ditë.

(ii) Parimet relevante

123. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës gjyqësore të konsoliduar të GJEDNJ-së, e cila është reflektuar edhe në praktikën e deritanishme gjyqësore të Gjykatës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përkatësisht kriteret që i referohen: (a) ndërlikueshmërisë së rastit; (b) sjelljes së palëve në procedurë; (c) sjelljes së gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih rastet e GJEDNJ-së *Mikulić kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafi 38; *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 41; dhe *Sürmeli kundër Gjermanisë*, nr. 75529/01, Aktgjykim i 8 qershorit 2006, paragrafi 128).

(iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

124. Ashtu siç është elaboruar edhe më sipër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës inicioi procedurën gjyqësore përmes padisë së dorëzuar në DHPGJSK me qëllim që të kërkojë njohje të plotë të statusit të saj si shoqëri aksionare, duke filluar nga vitit 1991, respektivisht

nga 29 maji 2003, pasi që AKP kishte marrë nën menaxhim fabrikën dhe se nuk ua njihte statusin e shoqërisë aksionare punëtorëve.

125. Në vijim të kësaj, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të marrë parasysh faktorët si në vijim: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e parashtruesit të kërkesës; (c) sjelljen e autoriteteve relevante gjyqësore; dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin e kërkesës në kontest.

Ndërlikueshmëria e rastit

126. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, përmes të cilave ishte theksuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje të faktit dhe të ligjit, por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih rastet e GJEDNJ-së *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë,* cituar më lart, paragrafi 55; *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 72; dhe *Humen kundër Polonisë*, nr. 26614/95, Aktgjykim i 15 tetorit 1999, paragrafi 63). Po ashtu, sipas GJEDNJ-së, në rastet kur një procedurë nuk është komplekse, mungesa e qartësisë dhe parashikueshmërisë në legjislacionin vendas mund ta vështirësojë zgjidhjen e rastit dhe të kontribuojë në kohëzgjatjen e procedurës (shih rastin e GJEDNJ-së *Famullia Katolike Greke e Lupenit dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 150).

127. Në rastin konkret, bazuar në informatën e dorëzuar nga DHPGJSK-ja, Gjykata vëren se padia e parashtrueses së kërkesës ende nuk ishte vendosur nga ana e DHPGJSK-së, për shkak se rasti ka kaluar nga një gjyqtar te një gjyqtar tjetër dhe se lidhur me rastin planifikojnë të mbajnë seancë dëgjimore gjatë muajit qershor 2025, por jo më larg se deri në muajin korrik 2025. Në këto rrethana, Gjykata, nga përgjigjja e dhënë nga DHPGJSK-ja, vëren se kërkesëpadia e parashtrueses së kërkesës nuk është vonuar që të shqyrtohet për shkak të ndërlikueshmërisë së rastit, pra rasti nuk ishte i ndërlikuar. Megjithatë, sipas përgjigjes së dhënë nga DHPGJSK-ja, me rastin nuk kanë proceduar, pasi që rasti ka qenë njëherë i caktuar te një gjyqtare dhe tani ka kaluar te një gjyqtar tjetër dhe se "*ka qenë e planifikuar që të mbahet seancë dëgjimore publike lidhur me kërkesën për vërtetimin e statusit të kësaj ndërmarrje, për vitin 2024, por mbas informatave që kemi pala kishte kërkuar fotokopjimin e shkresave të lëndës, dhe pastaj ka mbetur pa u caktuar seanca për shkak se për një kohë të caktuar shkresat e lëndës kanë qenë në shkrimore*".

Sjellja e parashtrueses së kërkesës

128. Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesave në parim kanë të drejtë të ndjekin të gjithë hapat proceduralë të vënë në dispozicion nga ligjet në fuqi. Megjithatë, parashtruesit e kërkesave duhet të kenë parasysh gjithashtu pasojat në rast se mjetet ligjore të shfrytëzuara mund të ndikojnë në kohëzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tyre. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve të kërkesave përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë sesa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së (shih rastet e GJEDNJ-së *McFarlane kundër Irlandës*, nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafin 148; *Eckle kundër Gjermanisë*, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

129. Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës ka shfrytëzuar mjetet juridike në dispozicion, siç është kërkesa për caktimin e masës së përkohshme, ku parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar vendosjen e masës së përkohshme, që përmes saj t'i ndalohet AKP-së shitja e ndërmarrjes deri në vendimin përfundimtar nga ana e DHPGJSK-së, dhe për të cilën masë DHPGJSK-ja kishte vendosur. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton qëndrimin e GJEDNJ-së që parashtruesit e kërkesave nuk mund të kritikohen për përdorimin e plotë të mjeteve juridike të disponueshme sipas ligjit të aplikueshëm (shih rastin e GJEDNJ-së *Eckle kundër Gjermanisë*, cituar më lart, paragrafi 82).

130. Lidhur me veprimet procedurale të parashtrueses së kërkesës, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së ku kishte sqaruar se parashtruesit të kërkesës i kërkohet të tregojë kujdes në ndërmarrjen e hapave proceduralë dhe për t'u përmbajtur nga përdorimi i taktikave të vonimit të shqyrtimit të rastit të tij (shih rastin e GJEDNJ-së: *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 17766/19, Aktgjykim i 12 tetorit 2021, paragrafi 91, ku GJEDNJ-ja kishte konstatuar se bazuar në sjelljen e ankuesit nuk ka tregues se ai ka shkaktuar apo kontribuar në zvarritje të procedurave).

131. Prandaj, duke u bazuar në veprimet e lartcekura të parashtrueses së kërkesës, Gjykata duke vënë theksin në sjelljen e saj, që nga data e parashtrimit të padisë më 4 gusht 2008, konsideron se veprimet e parashtrueses së kërkesës nuk mund të kenë ndikuar në vonesën e gjykatave të rregullta, respektivisht në shqyrtimin e rastit të tij, pasi që kërkesat për vendosjen e masës së përkohshme nuk kanë ndikuar në vonesën e DHPGJSK-së që të vendosë lidhur me meritat e rastit.

Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

132. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih rastet e GJEDNJ-së *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; *Abdoella kundër Holandës*, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24; dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, Aktgjykim i 7 dhjetorit 2010.

133. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja kishte theksuar se nuk mund të merret në konsideratë arsyetimi i gjykatave për mbingarkesën me lëndë të pazgjidhura (shih rastet e GJEDNJ-së *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, cituar më lart, paragrafët 70-71 dhe 94-96; dhe *Vocaturo kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 17).

134. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar padi kundër AKP-së më 4 gusht 2008. Në padinë e saj kundër AKP-së, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar njohjen e statusit të shoqërisë aksionare, si dhe kishte propozuar lëshimin e masës së përkohshme që të ndalohet AKP-ja nga shitja e ndërmarrjes. DHPGJSK-ja kishte vendosur ta miratojë kërkesën për lëshimin e masës paraprake të sigurisë dhe i ndaloi AKP-së shitjen e aseteve të hedhura për privatizim të New Co Metaliku Ena, Sh.a., i cili vendim ishte vërtetuar edhe nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së. Parashtruesja e kërkesës paraqiti kërkesë, ku kërkoi ndalimin e vendosjes së ndërmarrjes nën menaxhimin e AKP-së, ku edhe këtu nga gjykata kërkoi vendosjen e masës së përkohshme, e cila masë u vendos nga ana e DHPGJSK-së, dhe i cili vendim më vonë u ndryshua nga ana e Kolegjit të Apelit

të DHPGJSK-së, e cila refuzoi kërkesën për masë të përkohshme. Parashtruesja e kërkesës kërkoi përsëritje të procedurës, e cila kërkesë iu refuzua nga ana e Kolegjit të ankesave të DHPGJSK-së. Më tej, parashtruesja e kërkesës parashtroi një kërkesë dhe kërkoi nga gjykata që të lëshojë masë të përkohshme të sigurimit lidhur me vendimin e AKP-së për demontimin dhe rrënimin e objekteve të ndërmarrjes. DHPGJSK-ja e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtrueses së kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, me të cilën kërkonte t'i ndalohet të padituris AKP-së të lidhë kontrata dhe të rrënojë objekte dhe të ndërtojë në dëm të paditësit, respektivisht t'i ndalohet të zbatojë vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Vendimi i DHPGJSK-së u vërtetua edhe nga ana e Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së.

135. Lidhur me veprimet e organeve kompetente në procedurën e lartpërmendur, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies së tyre në lëvizje ishin aktive në gjykimin e çështjes sa i përket kërkesave për masë të përkohshme, ku gjatë gjithë procedurës janë nxjerrë gjithsej 7 (shtatë) vendime gjyqësore. Gjykata, në dritën e rrethanave të ndërlikuara të këtij rasti, duke marrë parasysh bazën ligjore komplekse, veprimet e shumta procedurale të palëve, interesat legjitime të tyre dhe mjetet ligjore të përdorura nga palët, si dhe faktin se gjykatat kanë nxjerrë gjithsej 7 (shtatë) vendime gjyqësore në këtë rast, arrin në përfundimin se gjykatat e rregullta, që nga momenti i vënies në lëvizje në këtë rast, nuk ishin pasive lidhur me kërkesat për masë të përkohshme. Mirëpo, duke marrë për bazë rrethanat e rastit konkret, Gjykata vlerëson se DHPGJSK-ja si rezultat i moscaktimit të seancave apo mosmbajtjes së seancës përgatitore apo edhe shtyrjes së seancave si pasojë e ndërrimit të gjyqtarëve, ose mosthirrjes në mënyrë të rregullt të ndërhyrësve në procedurë, kontribuoi në zvarritjen e vendimmarrjes për këtë çështje, e cila periudhë ka rezultuar në stërzgjatje të procedurës pranë DHPGJSK-së mbi gjashtëmbëdhjetë (16) vjet. Bazuar në shkresat e lëndës dhe në dritën e rrethanave të rastit, Gjykata konstaton se gjykatat e rregullta që nga momenti i vënies në lëvizje nuk ishin aktive në gjykimin e çështjes në merita dhe, rrjedhimisht, kanë shkaktuar kohëzgjatje të paarsyeshme të procedurës.

(d) Rëndësia e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest

136. Lidhur me kriterin e asaj çfarë rrezikon parashtruesi i kërkesës në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive. Sipas kësaj praktike, shembuj që kërkojnë kujdes të veçantë dhe zgjidhje me prioritet janë rastet që ndërlidhen me statusin dhe kapacitetin civil, rastet rreth kujdestarisë së fëmijëve dhe marrëdhënies prind-fëmijë, kontestet nga marrëdhënia e punës, rastet e parashtruesve që vuajnë nga *"sëmundje të pashërueshme"* dhe kanë *"pritje të reduktuar të jetëgjatësisë"*, si dhe rastet rreth të drejtës për arsim (shih rastin e GJEDNJ-së: *Frydlender kundër Francës*, cituar më lart, paragrafi 45).

137. Lidhur me këtë, Gjykata ka sqaruar kategoritë e caktuara të rasteve, të cilat për nga natyra e tyre duhet të trajtohen me kujdes të veçantë dhe të vendosen me shpejtësi më të madhe. Çështja e parashtruesit të kërkesës jo domosdoshmërisht hyn në atë kategori.

138. Thënë këtë, Gjykata thekson se nuk mund të konsiderohet e arsyeshme një periudhë kaq e gjatë kohore për zgjidhjen e një rasti të tillë pranë Gjykatës Themelore, pavarësisht natyrës së rastit. Gjykata konsideron se tejzgjatja e trajtimit të çështjes në fjalë është e papranueshme në rrethanat e rastit konkret dhe si e tillë është në kundërshtim të plotë me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, ashtu siç garantohet nga paragrafi 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së.

139. Si përfundim, Gjykata marrë parasysh aplikimin kumulativ të kritereve të lartcekura, konstaton se (i) megjithëse rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me një kontest civil, nuk rezulton të jetë i një natyre aq të ndërlikuar saqë do të mund të justifikonte që procedura gjyqësore për zgjidhjen e kontestit përkatës të mos përfundojë as për më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet; (ii) parashtruesja e kërkesës nuk ka kontribuar në tejzgjatjen e procedurës përmes veprimeve të saj, por vetëm ka ndjekur hapat proceduralë për realizimin e të drejtës së saj lidhur me pronën e kontestuar; ndërsa (iii) DHPGJSK-ja as pas më tepër se gjashtëmbëdhjetë (16) vjet nuk ka zgjidhur rastin e saj, pasi i njëjti ende pret për t'u zgjidhur nga DHPGJSK-ja si instancë e parë gjyqësore.

140. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se në rrethanat e parashtrueses së kërkesës, DHPGJSK-ja ka shkelur të drejtën e saj për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.

141. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se, pas këtij Aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, DHPGJSK-ja duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për ta përmbyllur çështjen juridike të parashtrueses të kërkesës me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit për moszbatim të vendimit për masë të përkohshme

Parimet e përgjithshme

142. Gjykata rikujton që e drejta për gjykim të drejtë kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike. (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Brumărescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykimi i 28 tetorit 1999).

143. GJEDNJ thekson se neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së duhet të interpretohet në dritën e Preambulës së Konventës, e cila deklaron ndër të tjera se sundimi i ligjit përbën pjesë të trashëgimisë së përbashkët të Shteteve Palë (shih rastin e GJEDNJ-së Advance Pharma sp. z o.o kundër Polonisë, nr. 1469/20, Aktgjykim i 3 shkurtit 2022, paragrafi 331).

144. Gjithashtu, GJEDNJ përsërit se e drejta për t'u paraqitur në gjykatë, e mbrojtur nga neni 6 i KEDNJ-së, do të ishte iluzore nëse sistemi juridik i një shteti palë do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe detyrues të mbetej i paekzekutuar, në dëm të njërës palë. Prandaj, ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga çdo gjykatë duhet të konsiderohet pjesë integrale e "gjykimit" për qëllimet e nenit 6 (shih rastet e GJEDNJ-së Hornsby kundër Greqisë, nr.18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafi 40, dhe Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 10613/16, Aktgjykim i 11 janarit 2018 paragrafi 92). Përndryshe, dispozitat e nenit 6, paragrafit 1 të Konventës do të zbrazeshin nga çdo efekt i dobishëm (shih rastin e GJEDNJ-së C.M. kundër Belgjikës, nr. 67957/12, Aktgjykim i 13 marsit 2018, paragrafi 55, dhe referencat e vendosura aty).

145. Për më tepër, Gjykata rikujton se GJEDNJ-ja ka përcaktuar që, përveç aktgjykimeve përfundimtare për meritat, edhe vendimet paraprake mund të bëhen *res judicata*. Kjo, sipas përkufizimit, zbatohet edhe për zbatimin e vendimeve gjyqësore që vendosin masa të

përkohshme, të cilat mbeten në fuqi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata në çështjen kryesore (shih rastet e GJEDNJ-së Sharxhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë, nr. 10613/16, cituar më lart, paragrafi 92 dhe Camara kundër Belgjikës, nr. 49255/22, Aktgjykim i 18 korrikut 2023, paragrafi 105). Të mendosh ndryshe do të nënkuptonte dhënien e një vendimi gjyqësor detyrues, ndonëse të përkohshëm, që është i zbrazët nga qëllimi dhe kuptimi.

146. Barra për të siguruar zbatimin e një vendimi bie kryesisht mbi autoritetet e atij shteti, duke filluar nga data kur vendimi bëhet përfundimtar dhe i zbatueshëm (shih rastet e GJEDNJ-së Burdov kundër Rusisë (nr. 2), nr. 33509/04, 2009, paragrafi 69; dhe Arbačiauskienė kundër Lituanisë, nr. 2971/08, Aktgjykim i 1 marsit 2016, paragrafi 86). GJEDNJ-ja ka shtjelluar parimin e sigurisë juridike në lidhje me të drejtën për gjykim të drejtë edhe në raste të tjera (Shih rastin e GJEDNJ-së: *Ryabykh kundër Rusisë*, kërkesa nr. 52854/99, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafët 52 dhe 56).

147. Parimet e përmendura më sipër janë të rëndësishme, në të cilat rezultati është vendimtar për të drejtat civile të një paditësi. Në këtë kontekst, Gjykata kujton se autoritetet administrative përbëjnë një element të një shteti të bazuar në sundimin e ligjit dhe interesat e tyre përputhen me nevojën për një administrim të drejtë të drejtësisë. Kur autoritetet administrative refuzojnë ose nuk arrijnë ta zbatojnë një vendim gjyqësor kundër shtetit, apo edhe vonojnë në zbatimin e tij, garancitë e nenit 6 që i janë ofruar paditësit gjatë fazës gjyqësore humbasin çdo qëllim (shih Hornsby, cituar më lart. paragrafi 41, dhe Cıngıllı Holding A.Ş. dhe Cıngıllıoğlu kundër Turqisë, nr. 31833/06 dhe 37538/06, Aktgjykim i 21 korrik 2015, paragrafi 38).

148. Gjykata Kushtetuese, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, gjithashtu ka shtjelluar çështjen e *res judicata* edhe lidhur me masën e sigurisë. Në Aktgjykimin e KI122/17 të 30 prillit 2018, parashtrues Česká Exportní Banka A.S, Gjykata në paragrafin 166 theksoi:

> *"166.Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës kishte pritje legjitime që rasti i tij, në lidhje me masat specifike të sigurisë të vërtetuara nga Gjykata e Apelit si të pajtueshme me ligjin, ishte vendosur përfundimisht nga Gjykata e Apelit dhe se nuk mund të rihapej nga vetë Gjykata e Apelit. Kësisoj, parashtruesi është dashur të jetë në gjendje të përfitojë nga këto vendime dhe t'i shihte ato të ekzekutuara.*

149. Për më tepër, në Aktgjykimin e 12 shkurtit 2016 në rastin nr. KI132/15, parashtrues Manastiri i Deçanit, Gjykata theksoi në paragrafët 95-97:

> *"95. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka pasur pritje legjitime që rasti i tij të ishte vendosur në instancën e fundit nga Paneli i pronësisë dhe se ajo nuk ka mundur të rihapet para Kolegjit të Apelit. Si i tillë, parashtruesi duhet të ketë pare aktgjykimet e Kolegjit të Pronësisë të ekzekutuara.*
>
> *96. Duke u bazuar në këto konsiderata dhe në praktikën e vet gjyqësore, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se aktgjykimet e Kolegjit të Apelit, të 27 dhjetorit 2012 (nr. SCC-08-0226 dhe nr. SCC-08-0227), ishin bërë res judicata në bazë të vendimit të mëparshëm të formës së prere dhe të detyrueshëm të Kolegjit të Apelit, të 24 korrikut 2010, në lidhje me palët e autorizuara*

97. Duke përdorur procedurën e ankesës për të anuluar këto aktgjykime të Panelit të Pronësisë dhe për të referuar kontestin origjinal të pronësisë përsëri në gjykatat e rregullta, Gjykata konstaton se, me vendimet e tij të 12 qershorit 2015 (nr. AC-I-13-0008 dhe nr. AC-1-13-0009), Kolegji i Ankesave ka cenuar parimin e sigurisë juridike dhe i ka mohuar parashtruesit një gjykim të drejte dhe të paanshëm për të drejtat dhe detyrimet e tij brenda kuptimit të nenit 31, paragrafi 2, të Kushtetutës dhe të nenit 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së".

150. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së e përmendur më sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës përfshin parimin e sigurisë juridike, i cili përfshin parimin që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave.

151. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parimi *res judicata* aplikohet jo vetëm për vendimet gjyqësore përfundimtare, por edhe për vendimet paraprake që nxirren në pritje të rezultatit të një vendimi përfundimtar (shih rastin e Gjykatës: KI122/17 parashtrues Česká Exportní Banka A.S., Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 158).

Zbatimi i parimeve në rastin konkret

152. Gjykata vëren se më 23 shtator 2011, DHPGJSK-ja vendosi për lëshimin e masës paraprake- masës të përkohshme të sigurisë përmes së cilës AKP-së i ndalohet shitja e aseteve të hedhura në privatizim të parashtrueses së kërkesës. Gjykata gjithashtu vëren se, DHPGJSK-ja vendosi që masa paraprake do të mbetet në fuqi deri në vendimin përfundimtar sipas padisë të parashtruar nga parashtruesja e kërkesës. Në çdo rast, Gjykata vëren se vendimi për masë paraprake të sigurisë u bë i formës së prerë më 4 mars 2015, kur Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së e refuzoi ankesën e AKP-së (shih paragrafin 44 më lart).

153. Gjykata, gjithashtu vëren se, duke marrë parasysh faktin se qëllimi kryesor i vendimit të DHPGJSK-së për masë paraprake të sigurisë ishte të pezullonte shitjen e aseteve të hedhura në privatizim të parashtrueses së kërkesës deri në shpalljen e një vendimi për meritat nga kjo gjykatë. Megjithatë, AKP-ja nuk e respektoi siç duhet këtë vendim. Në këtë kontekst, më 25 shtator 2017, Bordi i Drejtorëve të AKP-së vendosi që Fabrika e Enëve "ENA" sh.a të vendoset nën administrimin e drejtpërdrejtë të AKP-së dhe që AKP të marrë përsipër kontrollin e drejtpërdrejtë mbi këtë ndërmarrje, duke përfshirë këtu llogaritë bankare dhe asetet (shih paragrafin 45 më lart). Gjithashtu, më 24 mars 2022, AKP-ja shpalli ofertë për zhvendosjen e pajisjeve nga repartet e fabrikës dhe më 8 gusht 2022 lidhi kontratë me "Viva Fresh Sh.p.k" për demontimin e makinerisë, rrënimin e objekteve dhe infrastrukturës dhe ndërtimin e qendrës tregtare afariste. Lidhur me këtë, AKP-ja iu referua nenit 6 të Ligjit të Agjencisë 04/L-034, kur justifikoi masat e marra pas vendimit për masë të përkohshme. Pa dyshim, ky nen, siç ishte në fuqi në atë kohë, lejonte që Agjencia ka kompetenca të gjera dhe ekskluzive administrative mbi ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet, dhe çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të agjencisë për të mundësuar më mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Megjithatë, Gjykata konsideron se kjo rrethanë nuk e ndryshon faktin se vendimi për masë të përkohshme, i cili kishte si qëllim pezullimin e shitjes së aseteve në pritje të një vendimi

për meritat nga DHPGJSK-ja, u bë i pavlefshëm nga vendimet e Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

154. Në këtë pikë, Gjykata e gjen të rëndësishme të vërejë se, pas vendimit për masë të përkohshme të sigurisë të 23 shtatorit 2011 të DHPGJSK-së , i cili u bë i formës së prerë, sjellja e AKP-së në këtë rast ishte qartësisht në kundërshtim me qëllimin e këtij vendimi, duke qenë se ende nuk është definuar statusi juridik i parashtrueses të kërkesës, dhe se demontimi, rrënimi i objekteve dhe shitja e aseteve të fabrikës do të rezultonte në një dëm të menjëhershëm dhe të pariparueshëm. Në këtë kuadër, Gjykata gjithashtu vëren se demontimi i makinerisë, rrënimi i objekteve dhe infrastrukturës dhe ndërtimi i qendrës tregtare afariste, nënkupton atë që AKP-ja ka shmangur zbatimin e një vendimi gjyqësor të detyrueshëm, duke lidhur kontratë me "Viva Fresh Sh.p.k.. Gjykata vëren gjithashtu se GJEDNJ-ja ka theksuar shpesh se dështimi i autoriteteve për të zbatuar siç duhet vendimet gjyqësore – duke përfshirë vendimet përkohësisht të detyrueshme (masat e përkohshme) dhe të zbatuara (shih rastet e GJEDNJ-së: Okyay dhe të tjerë kundër Turqisë, nr. 36220/97, paragrafi 73, ECHR 2005-VII, dhe Mehmet Taner Şentürk, të përmendur më lart, paragrafët 41-42) – është në kundërshtim me sundimin e ligjit dhe parimin e sigurisë juridike (shih gjithashtu Hornsby kundër Greqisë, të përmendur më lart, paragrafët 40-41, dhe Dolińska-Ficek dhe Ozimek kundër Polonisë, nr. 49868/19 dhe 57511/19, paragrafi 328, 8 nëntor 2021).

155. Gjykata vëren se në këtë rast vendimi për masë të përkohshme të sigurisë nuk u zbatua gjatë gjithë periudhës që kishte si qëllim ruajtjen e status quo-së dhe parandalimin e çdo dëmtimi për parashtruesen.

156. Gjykata ka shqyrtuar qasjen që DHPGJSK-ja ka miratuar me Aktvendimin [SCC-08-0243] e 5 tetorit 2023, dhe i cili ishte vërtetuar edhe nga Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001] të 9 nëntorit 2023. Sipas kësaj qasjeje, vendimi për masë të përkohshme të sigurisë i DHPGJSK-së [SCC-08-0243] i 23 shtatorit 2011, e i cili Aktvendim është vërtetuar me Aktvendimin e Kolegjit të Apelit [ASC-112-0088] të 4 marsit 2015, përmes të cilëve janë siguruar asetet të mos shiten deri në përfundimin e kontestit në lidhje me statusin e ndërmarrjes, është respektuar, dhe se veprimet e AKP-së janë në kuadër të autorizimeve ligjore dhe kompetencave të saj në lidhje me administrimin e pronës në fjalë.

157. Gjykata vlerëson se një qasje e tillë e DHPGJSK-së, e vendosur përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] të 5 tetorit 2023 dhe Kolegjit të Apelit të DHPGJSK-së përmes Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001] të 9 nëntorit 2023 mund të dëmtojë funksionimin e duhur të mekanizmit të masës së përkohshme dhe të dëmtojë qëllimin e saj, që është të parandalojë dëmin derisa të merret vendimi përfundimtar. Po ashtu, moszbatimi i një vendimi të përkohshëm mund të bëjë që një vendim përfundimtar të mos mund të rregullojë dëmet që mund të kenë ndodhur gjatë periudhës së pezullimit. Gjykata thekson se, edhe nëse moszbatimi i masës së përkohshme të sigurisë nuk pengon përfundimisht vendimin përfundimtar, ndodhin raste kur dëmet janë të pakthyeshme dhe nuk mund të korrigjohen më vonë.

158. Bazuar në këto shqyrtime dhe në praktikën e mëparshme gjyqësore të saj, si dhe në atë të GJEDNJ-së, Gjykata konkludon se Aktvendimi DHPGJSK-së [SCC-08-0243] i 23 shtatorit 2011, e i cili Aktvendim është vërtetuar me Aktvendimin e Kolegjit [ASC-112-0088] të 4 marsit 2015, ishin bërë *res judicata*.

159. Gjykata konsideron se DHPGJS përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] të 5 tetorit 2023 dhe Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-23-0613-A0001] të 9 nëntorit 2023 kishin shkelur parimin e sigurisë juridike dhe i kishin mohuar parashtrueses së kërkesës një gjykim të drejtë dhe të paanshëm lidhur me të drejtat dhe detyrimet e saj brenda kuptimit të nenit 31, paragrafit 2 i Kushtetutës dhe nenit 6, paragrafit 1 të KEDNJ-së. Për pasojë, ka pasur një shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Përkitazi me pretendimin për mosmbajtje të seancës dëgjimore

160. Parashtruesja e kërkesës pretendon që Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së me mosmbajtjen e seancës dëgjimore ka shkelur parimin e qasjes në drejtësi, ku theksoi se "*...Para së gjithash konsideroj se nuk janë plotësuar kushtet që çështja të procedohet pa seancë dëgjimore ... me nenin 306 të LPK-së është përcaktuar se me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur gjykata mund të caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit*" .

161. Gjykata vëren se në rastin konkret, Kolegji i Apelit nuk mbajti seancë dëgjimore gjatë procedurës gjyqësore. Kolegji i Apelit në Aktgjykimin [AC-I-23-0613-A0001] e 9 nëntorit 2023 kishte theksuar se "*Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore e procedurës.*"

162. Praktika gjyqësore e Gjykatës ka gjetur shkelje për mosmbajtje të seancës dëgjimore kur Kolegji i Apelit e kishte prishur vendimin e shkallës së parë në dëm të parashtruesve të kërkesës. Gjykata thekson se në rastin konkret, shkalla e parë e DHPGJSK-së e kishte refuzuar kërkesën për masë të sigurisë të parashtrueses së kërkesës dhe se kishte mbajtur seancë dëgjimore. Kolegji i Apelit e kishte vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë të DHPGJSK-së dhe e kishte refuzuar ankesën e parashtrueses së kërkesës. Gjykata vlerëson se neni 69.1 i Ligjit për DHPGJSK-në, të cilit i është referuar Kolegji i Apelit, i jep mundësinë kësaj të fundit të vendosë nëse do të mbajë seanca dëgjimore apo jo. Pra, është në diskrecionin e saj që të vendosë për një çështje të tillë, varësisht prej karakteristikave të rastit.

Pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

163. Gjykata rikujton se i konsideroi të pranueshme pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkelje të së drejtës për "*gjykim të drejtë*" në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore dhe parimin e sigurisë juridike si rezultat i mosrespektimit të vendimit të formës së prerë.

164. Referuar pretendimeve të parashtrueses të kërkesës për shkelje të së drejtës së pronës, Gjykata vëren se argumenti kryesor i parashtrueses të kërkesës ka të bëjë me çështjen se deri te shkelja e nenit 46 të Kushtetutës ka ardhur "*... Gjatë seancës dëgjimore dhe në parashtresa është propozuar Kolegjit të shkallës së parë që të bëjë vendshiqimin në vend dhe të konstatoj gjendjen dhe se veprimet që janë ndërmarrë nuk janë veprime një vjeçare por ajo kontratë është bishterim i ligjit dhe angazhim për përpjekje që të privohen aksionet nga prona e tyre [...] objekt i atakimit me këtë kërkesë është shkelja nga DHPGJSK ... e të drejtave pronësore të subjektit personit juridik parashtrues i kësaj*

kërkese dhe punëtorëve të saj". Pra, parashtruesja e kërkesës në esencë pretendon se me lejimin e AKP-së për demontimin e fabrikës, rrënimin dhe lëshimin e objekteve të ndërmarrjes me qira, asaj i janë shkelur të drejtat e mbrojtura me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës.

165. Bazuar në shkresat e lëndës, rezulton se procedura në lidhje me vërtetimin dhe njohjen e të drejtës së pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese, është ende duke u shqyrtuar nga ana e DHPGJS-së, pra ende nuk është vendosur në meritat e rastit. Një rrethanë e tillë, e cilëson pretendimin konkret si pretendim të parakohshëm, përkatësisht "*kërkesë e parakohshme*", sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së.

166. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike, sipas paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i obligon të gjithë personat fizikë dhe juridikë që dëshirojnë të paraqesin kërkesë në Gjykatë, që së pari të shterojnë mjetet juridike efektive në dispozicion kundër aktit të kontestuar.

167. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se ajo nuk mund të shndërrohet në gjykatë të fakteve dhe të vërtetojë të drejtën e pronësisë ose të rikthejë në posedim faktik dhe juridik një prone të caktuar, sepse një juridiksion i tillë, si rregull, u takon gjykatave të rregullta për ta bërë këtë.

168. Gjykata thekson se ky konstatim i Gjykatës nuk e pengon parashtruesen e kërkesës që në të ardhmen, sërish, të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor pas shterimit të të gjitha mjeteve efektive juridike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

169. Si përfundim, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton që pretendimet e parashtrueses së kërkesës lidhur me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës cilësohen si pretendime që i përkasin kategorisë së *"kërkesës së parakohshme"*, dhe rrjedhimisht, refuzohen në pajtim me nenin 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës.

Përfundim

170. Si përfundim, Gjykata konstaton se DHPGJSK-ja ka shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm, të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Gjithashtu, Gjykata konstaton se duke mos respektuar parimin e sigurisë juridike dhe respektimin e një vendimi të formës së prerë të gjykatës, si dhe duke mos trajtuar pretendimet e parashtrueses në lidhje me çështjet *res judicata*, Kolegji i Apelit i DHPGJSK-së ka shkelur të drejtën e parashtrueses së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafin 1 të KEDNJ-së.

171. Sa i përket pretendimeve për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se këto pretendime janë të parakohshme për shqyrtim, dhe të njëjtat mund të jenë objekt shqyrtimi i Gjykatës Kushtetuese pas vendimit përfundimtar të gjykatave të rregullta.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 5 nëntor 2025:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË, njëzëri, se ka shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati kohor të arsyeshëm;

III. TË KONSTATOJË, me pesë (5) vota për dhe dy (2) kundër, se ka shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkatësisht shkelje të parimit të sigurisë juridike;

IV. TË URDHËROJË Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës që të vendosë lidhur me meritat e rastit më së largu deri më 1 qershor 2026 dhe të njoftojë Gjykatën, në pajtim me nën rregullin (5) të rregullit 60 të Rregullores së punës, për masat e ndërmarra për ta zbatuar Aktgjykimin e Gjykatës;

V. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

VI. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe

VII. TË KONSTATOJË që ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Radomir Laban Nexhmi Rexhepi